

INTERVISTË ME OLIVERA BUDIMIRIN

E realizuar nga forumZFD

Beograd | Data: 13 korrik, 2016

Kohëzgjatja: 162 minuta

Të pranishëm:

1. Olivera Budimir (E intervistuar)
2. Natasa Govedarica (Intervistuesja)
3. Boris Sebez (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - e intervistuar shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e parë

Natasa Govedarica: Do ju lusja që fillimisht të prezantoheni, të tregoni emrin tuaj dhe diçka për origjinën e familjes tuaj, si dhe kujtimet tuaja më të hershme.

Olivera Budimir: Unë jam Ollivera Budimir. Përndryshe jam nga Prishtina, kurse tani jetoj në Beograd. Kam ikur për në Beograd në vitin '99 pas ngjarjeve në Kosovë, pas luftës në Kosovë dhe gjithmonë e theksoj atë, unë nuk kam ardhur, por kam ikur pikërisht sepse nuk është e njëjtë të shkosh dhe ikësh. Sepse të skosh është zgjedhje, është vullnet i mirë dhe të ikësh është detyrim, të cilës të gjithë i rezistojmë. Në fakt, unë gjithmonë kam jetuar në Prishtinë me prindërit e mi, vëllezërit, dhe pastaj me bashkëshortin tim, aty jam martuar. Kam punuar, ai punonte, kemi pasur një jetë të bukur, një martesë të bukur. Edhe familja e tij dhe e imja kanë qenë të kësaj ane, të kësaj rrethine. Është një qytet relativisht i vogël, por jo aq i vogël sa mos t'i ketë edhe komponentet e një qyteti të madh, kështu që të ka ofruar një jetesë të rehatshme dhe të mirë. Kurrë nuk kemi pasur ndonjë problem me fqinjët tanë, ne nuk jemi të ngarkuar, nuk jemi edukuar në atë mënyrë as familja e bashkëshortit dhe as e imja, në mënyrë që të jemi të ngarkuar si nacionalist apo në baza etnike, a sidoqoftë, kështu që kemi jetuar të qetë.

Edhe ai edhe unë kemi arritur deri te një status. Kemi pasur një jetë të mirë në qytet dhe mendonim që e gjitha ishte duke shkuar në një drejtim normal. Pikërisht në prag të luftës, rastisi që ne donim të zgjerohim familjen, t'i krijojmë pasardhësit dhe ta plotësojmë atë dëshirë në mënyrë që të jemi një familje e plotë. Sidoqoftë, ndodhi lufta, dhe u bë humnerë. Pastaj ndodhi gjithçka që nuk është dashur të ndodhte dhe kështu edhe jeta e tij e njëkohësisht edhe e imja u ndal diku në pikën zero, janë ndaluar nga një, nuk mund të thuhet fuqi më e lartë por për shkak të neglizhencës dhe papërgjegjësisë së disa njerëzve apo ngjashëm, politike apo ngjashëm.

Natasa Govedarica: Cilat janë kujtimet e para të jetës tuaj familjare në Prishtinë, ju keni lindur në Prishtinë dhe aty keni jetuar me familjen tuaj, si e kujtoni atë periudhë?

Olivera Budimir: Babai im është vendas, babai im ka lindur në Prishtinë, gjithashtu edhe prindërit e tij. Pra, të gjitha kujtimet e mia janë të lidhura me Prishtinën, përveç kësaj, këtë nuk e kam thënë më herët, por ngjashëm, ngjarjet, ngjarjet e këqija, ngjarjet nacionaliste për fat të keq ndodhën edhe para luftës dhe gjatë asaj luftës tjetër. Deri atëherë kanë qenë [Lufta Botërore] e Para dhe e Dyta, dhe shumë më herët, pasi që babai im në vitin '43 kishte ikur njëherë nga Prishtina. Ai e la gjithë pronën e tij dhe u kthye me dëshirën e tij pas vatrës së tij. Duhet theksuar që shtëpinë dhe pronën nuk i ka kthyer asnjëherë. Ajo ka mbetur ashtu deri në këtë ditë, por ai kishte nevojë të jetë aty. Të gjithë ne ishim aty, dhe të gjithë u rritëm aty, me vëllezërit e mi, tre vëllezërit dhe unë. Por për nga natyra i ati im ka qenë një njeri i qetë dhe nuk ka dashur që me askënd, për shkak të fushave dhe livadheve, siç do të thuhej, shkak i pronave të shkaktoj mosmarrëveshje më askënd, kështu që gjithë ajo ka ngelur në një tjetër plan.

Për të më e rëndësishme ishte familja, shëndeti i fëmijëve të tij dhe të mos kemi mosmarrëveshje me askënd, në mënyrë që të jetojmë gjithmonë në paqe, sepse ai gjithmonë më ka thënë që fëmijët e mi janë më të rëndësishmit. Asgjë nga pasuria nuk mund të na kompenzojë. Kështu që unë kam... ai e ka përjetuar tashmë këtë dëbim në lëkurën e tij. U kthye si një proletar me asgjë, pa pronë, pa shtëpi dhe pastaj ne e kemi rikrijuar gjithë atë, edhe ai edhe nëna dhe normalisht edhe ne më vonë, kur ishim duke u rritur. Dhe përsëri, ne kemi krijuar një vend dhe pothuajse nga asgjë e kemi ndërtuar përsëri. Unë disi e kam në mendjen time që, ai që ka pasur, ai do të ketë përsëri, sepse do të përpiqet të arrijë dhe përsëri do ta kompenzojë atë, sepse prona gjithmonë kompenzohet, vetëm jeta nuk mundet. Kështu që, asnjëri nga ne nuk ka qenë i ngarkuar as me pronë dhe as me faktin që ne nuk kishim asgjë për momentin, do të arrijmë të fitojmë një ditë, kjo asnjëherë nuk na ka shqetësuar.

Megjithatë, kemi jetuar në mënyrë paqësore, të qetë, kemi mësuar në shkollë, e kemi përfunduar atë, disi kemi arritur deri te punësimi. Kanë qenë rreth katër me një, shtatë me një në krahasim, nuk mund të them, shqiptarët. Dikur ata ishin *šiptari*¹, më pas shqiptarë, me gjithë respektin sepse të gjithë kanë të drejtë të thërrasin vetën ashtu siç duan, unë e respektoj këtë, pse jo. Unë tani mund të them se jam

¹ Serbisht: *Šiptar*, që do të thotë Shqiptar/e. Ky është një term nënçmues për shqiptarët nga Kosova, pasi që ka për qëllim të krijimit të dallimit mes shqiptarëve të Kosovës dhe Shqipërisë. Folësja e lakon këtë term edhe kur i referohet gjuhës shqipe, e quan atë gjuhë *šiptarski*, dhe e përdorë atë edhe kur është nevoja diçka të identifikohet si shqiptare.

afrikane dhe të gjithë mund të thonë dhe çfarë pastaj, çdokush mund të jetë, apo jo? Kjo është kaq relative, kjo është zgjedhje. Por në librezën time të shkollës ku kam mësuar, shkruan gjuha *šiptarski*, por pas një kohe pas miratimit të Kushtetutës është ndryshuar në gjuha shqipe, por mirë, edhe kjo është e parëndësishme. Sidoqoftë, babai im e fliste *šiptarski* dhe jo gjuhën shqipe sepse ai vet thoshte, “Unë atë gjuhën që ju jeni duke e mësuar në shkollë tani, nuk e kuptoj.”

Ai e fliste gjuhën *šiptarski* me popullsinë lokale si gjuhë amtare. Këtu mendoj unë fliste gjuhën rome ashtu siç fliste frëngjishten dhe italishten, sepse aty e kanë punuar hekurudhën dhe u mësua me ata aty. Ishte, mendoj që të gjithë në atë kohë në qytet, në atë periudhë kohore kur babai im është rritur dhe ka jetuar, e gjithë popullsia ka folur të gjitha gjuhët, të gjitha gjuhët lokale sepse në atë mënyrë e kanë respektuar njëri-tjetrin, por gjithmonë kanë ndodhur disa gjëra, por ato ishin disi jashtë qytetit, jashtë disa ndjesive dhe njohurive tona, kështu që ne kemi jetuar në mënyrë paqësore, kemi jetuar në mënyrë paqësore.

Natasa Govedarica: Ju jeni vajza e vetme apo motra e vetme nga tre vëllezërit. A ju ka sjellë ky pozicion ndonjë privilegj apo herë pas here ishte... të themi problematike? Si jeni trajtuar në familjen tuaj, dhe si në shoqëri përderisa rriteshit, gjatë shkollimit?

Olivera Budimir: Në familje më duhet të them, duke qenë se isha vajza e vetme, në disa raste, në një mënyrë isha e mbrojtur, por në mënyrën tjetër jo. Unë nuk e kam kërkuar këtë sepse jam tip i tillë. E di që prindërit e mi vetëm mua ma festonin ditëlindjen, gjithmonë e festoj. Vëllezërve mezi dihej se kur e kishin, por ditëlindja ime është shënuar të paktën qoftë në mënyrë minimale apo sidoqoftë, disi më janë plotësuar dëshirat. Sa i përket vëllezërve gjithmonë kam gëzuar një vend, “Ajo është ajo”, dhe kështu ishte. Nuk diskutohet, vëllezërit e mi kurrë dhe as sot e kësaj dite nuk kanë sharë para meje shkakun i një ndjenje të brendshme dhe jo për faktin që dikush u ka thënë që të mos e bëjnë, por thjeshtë ishte ashtu. Ne jemi, në Kosovë e keni pak atë, ne jemi patriarkal kundrejt familjes, i mbrojmë motrat, vëllezërit, jemi mjaftë të lidhur dhe më pëlqen që është ashtu. Por unë kam qenë në një vend të veçantë, por përsëri kam pasur një tjetër.

Nëna ime ishte nga Serbia, nga Bllaca serbe. Ajo është mësuar që fëmiu i gjinisë femërore duhet të punoj dhe kështu mua gjithmonë më është dashur t’i ndihmoj nënës, gjithmonë më është dashur të jem e rritura, gjithmonë më është dashur që, “Ju luani, kurse ti duhet të më ndihmosh!” Pra, në disa raste, në një formë kam qenë e mbrojtura dhe e preferuara, kurse në disa jo. Prap, unë jam një tip i tillë që e kam ndjenjën më tepër i mbroj tre vëllezërit e mi, se sa ata mua, sepse ajo mund t’i bëjë të gjitha dhe ajo nuk ka nevojë për mbrojtje, dhe unë jam disi si një lloj skifteri. Me gjasë kështu janë

motrat... dhe kështu duhet të jenë. Nuk e di, do doja të kisha një motër, por qofshin të gjallë vëllezërit e mi.

Natasa Govedarica: Cili fëmijë me radhë jeni ju?

Olivera Budimir: I dyti, i dyti.

Natasa Govedarica: Tani, kur flisni për arsimimin, ju keni përfunduar shkollën fillore në Prishtinë, filloren dhe të mesmen?

Olivera Budimir: Po, dhe kam studiuar në Beograd, edhe në Prishtinë, por edhe në Beograd.

Natasa Govedarica: Dhe si dukej gjithë kjo? Cilat kanë qenë këto vite kur ju keni shkuar në shkollë fillore në Prishtinë? Janë diku... vitet gjashtëdhjetë?

Olivera Budimir: Ashtu, nuk e di tani se kur jam regjistruar. E di që kam studiuar në vitet shtatëdhjetë e disa. Mendoj që këto janë disa prej viteve të një periudhe të bukur, kur askush nuk kishte dhe të gjithë kishim, ne të gjithë kemi pasur paqe në shpirt dhe unë e dua atë pjesë të jetës sonë sepse kemi qenë edhe në shkollë edhe gjithandej disi të barabartë. Në mes njerëzve nuk janë ndjerë dallime të mëdha të standardit të mënyrës së jetesës, por kemi qenë të afërt, kemi shkuar në shkollë bashkë, edhe fëmijët e zyrtarëve edhe fëmijët e punëtorëve në të njëjtën klasë. Nuk kishte dallime të mëdha dhe trazira, kurse sa i përket asaj që shkolla ka pasur dy apo tri gjuhë, atëherë ishte edhe departamenti i gjuhës turke. Aty kemi qenë paralel, nuk kemi qenë asnjëherë së bashku. Gjithkush ka shkuar në klasën e tij, gjithkush shihej me shokun e tij dhe askush nuk e ka parë apo takuar atë tjetrin me përjashtim të fëmijëve të lagjes me të cilët gjithashtu jemi shoqëruar pa ndonjë neveri, pa, nuk kishte diçka që na ka penguar. Edhe pse prindërit e mi nuk na kishin thënë mua apo vëllezërve të mi, “Mos u shoqëroni me atë, apo ai është i këtillë apo atillë”. Nuk ka qenë absolutisht ashtu. Vetvetiu e kemi zgjedhur shoqërinë tonë, por nuk dihet pse mirëpo bëhej një lloj filtrimi në atë mënyrë që gjithmonë jemi shoqëruar në disa qarqe tona. Do të thotë, kemi jetuar në mënyrë paralele.

Natasa Govedarica: Sa i përket barrierave gjuhësore, ju përmendët që qysh në shkollë fillore, që babai juaj fliste gjuhë të ndryshme, ju a keni mësuar diçka në shkollë?

Olivera Budimir: Kjo është shumë karakteristike. Ne kemi mësuar në shkollë që nga klasa e katërt, unë kam mësuar në shkollë gjuhën *šiptarski* dhe pastaj diku në klasën e shtatë, gjashtë, shtatë që ishte gjuhë shqipe, kurse në librezën shkollë ishte gjuha *šiptarski*. Dhe pastaj kemi mësuar komunikimin bazik, si gjithë fëmijët. Kemi mësuar këngë, kemi mësuar të gjitha këto, megjithatë,

babai im i fliste gjuhët si gjuhën amtare. Ne kurrë nuk e kemi mësuar, unë kurrë nuk e kam mësuar. Ndoshta shkaku që në një periudhë ka filluar një presion që duhej ta mësonim. Kur njeriut i thuhet që duhet të bëjë diçka ai nuk e bënë atë. Babait tim askush nuk i ka bërë presion që ai të detyrohet ta mësoj, por ata të gjithë e kanë mësuar, ata e dinin. Por neve na është thënë se duhej ta mësojmë. E pra nuk kam për ta bërë, në qoftë se duhet nuk do ta bëjë, nëse nevojitet do e mësoj.

Kjo është diçka e brendshme, nuk është kjo tani të mendosh ashtu. Në atë kohë nuk kam menduar për këtë, vetëm e di që nuk e kemi... unë nuk e kam folur. E kam kuptuar mjaftë por shumë pak e kam folur dhe tani e njëjta, por me të vërtetë, thjesht nuk kam pasur nevojë, sepse ata të gjithë e dinin gjithmonë gjuhën serbe. Ne mendonim se ishte e natyrshme për shkak se administrata ishte në gjuhën serbe, sepse duhej të vije në komunë, duhet të vije në shërbimin e oficerisë. Në rregull, kishte edhe dygjuhësi, por nuk mundemi të gjithë t'i kemi të gjitha, gjithashtu disa gjëra edhe duhej të fliteshin. Kështu që ka qenë disi, nuk e di si, por ata të gjithë e dinin, edhe pse ata ishin në një kohë, jo gjithmonë, por në një periudhë ishin shumicë, por të gjithë e dinin më duket që nga lindja. A ka qenë kjo ndjenjë e tyre, nuk e kam idenë, asnjëherë nuk e kam kuptuar këtë, jo që nuk e kam menduar.

Më kujtohet kur nipi, kur është martuar vëllau im, kjo ka qenë në vitet e '80-ta kur atij i lindi dhe kur iu rrit djali '86 - '87, kur ai tashmë ishte djalos dhe ai njëjtë shoqërohej me fëmijët e tjerë të rrugicës sonë. Ai është, të gjithë ata janë të vegjël, kaq të vegjël {tregon me duar} dinin [gjuhën] e vinin tek ai në oborr, e thërrasin dhe flasin me të, lozin së bashku dhe e thirrin, "Dejan, eja!" dhe ikin bashkë dhe lozin dhe kështu. Ai kurrë nuk e mësoi. Por askush nuk i ka thënë të mos e bëjë, pse kjo është kështu unë nuk e di. Por ai kurrë nuk i ka thënë, "Mos e bëjë Dejan!" Por si mund t'i thoshim kur ai tashmë është duke lozur me ta, kur askush nuk e ka penguar që të shkojë nëpër festa të ditëlindjeve, të lozin, të shoqërohen, të lozin në oborr, në oborr tonin, por nuk e mësoi. Kjo me gjasë është ajo rezistenca sepse është ndjerë një lloj, diçka që duhet... por kur ka rezistencë gjithmonë është diçka e vogël.

Natasa Govedarica: Po më vonë në shkollën e mesme ose gjimnaz, çfarë keni përfunduar?

Olivera Budimir: Shkollën e Mesme të Mjekësisë.

Natasa Govedarica: Në Prishtinë gjithashtu?

Olivera Budimir: Po.

Natasa Govedarica: A ka diçka të veçantë që ju mbani mend nga kjo periudhë e shkollës së mesme, ndonjë miqësi, dashuritë e para. Çfarë ndodhte në atë kohë?

Olivera Budimir: E pra, në shkollë të mesme kam qenë një nxënëse shembullore.

Natasa Govedarica: Siç edhe e kam pritur.

Olivera Budimir: Kryetare e klasës, unë kam qenë sekretare e shkollës, e organizatave studentore apo sido që janë quajtur ato, organizatat e të rinjve të shkollës. Unë kam qenë aq aktive, më kanë përzgjedhur këtu dhe atje, gjithandej më kanë përzgjedhur mua disi. Kështu që unë kam qenë disi, kam menduar që jam fëmijë i urtë, por kam qenë nxënëse e mirë, kam qenë nxënëse e mirë, shembull për klasën dhe kam pasur kujtime të mira dhe kam në përgjithësi kujtime të mira nga shkolla. Nuk kam qenë fëmijë problematik në asnjë formë. Normalisht, ka pasur aty edhe këngë dashurie dhe gjitha ato që e përcjellin atë. Nuk [kam qenë problematike]. Kisha edhe përkrahjen e prindërve të mi dhe kështu. Po edukimi... ajo që është me rëndësi është t'u tregosh prindërve tuaj e pastaj t'a thonë fqinjët sepse...përse të pëshpëritin fqinjët kurse prindërit të mos e dinë. E kanë kuptuar prindërit që kjo ishte periudhë e rritjes dhe që ashtu duhej, që ashtu duhej të ishte, kështu që nuk ka pasur... [probleme]. Ishte mirë t'i rikthehemi këtyre kujtimeve, por mirë, kjo është e gjitha.

Disa jetë tona që kalojnë, të cilat shënojnë një kohë të rinisë sonë, por unë mendoj se kam jetuar shumë shpejt. Unë gjithmonë kam jetuar shumë shpejtë. Më pëlqente të shoqërohem dhe të dal, i kisha disa hobi që i kam edhe sot. Si studente më pas kam filluar edhe të qep për shoqet e mija sepse, “Ma bëj mua një? Ma bëj mua një? Kush ta ka qepur? Unë vetë” {imiton bisedat me shoqe}. Më pas, në një periudhë kur e kisha të lirë, kam qepur, kam fituar para sepse nuk ka qenë ajo kohë kur të rinjtë kanë fituar para me të vërtetë, disi nuk ka qenë ashtu. Por unë kisha një ide timen... askush nuk më detyronte. Unë kam dashur dhe kështu kam punuar dhe pastaj në kohën e provimeve unë i kam kaluar ato dhe kam shkuar rregullisht në fakultet dhe të gjithë e kanë ditur, “Ola tani po i kalon provimet”, dhe kështu ishte. Kur kam kohë të lirë unë ulëm qepi, fitoj para, shkoj në bregdet me shoqërinë dhe kthehem ose blej për shtëpi këtë, atë, pra për ato dëshira që kisha, e që kushtonin më shumë se sa që prindërit e mi mundeshin të m'i realizonin. Kështu që ka qenë mirë dhe kam qenë aktive dhe mendoj që kam jetuar treqind në orë dhe kam pasur mjaftë kohë edhe për vëllezërit edhe për vete. Unë kam veshur xhemperët më të mirë, më modernët në atë kohë, pantallonat e parë në formë kambane të cilët i kam qepur vet sepse kisha dëshirë të jenë të bukur, t'ua bëja atë. Kjo ishte, e bukur ishte kjo.

Natasa Govedarica: Çfarë kishit zgjedhur për të studiuar?

Olivera Budimir: Së pari kam studiuar frëngjisht në Prishtinë, po, dhe pastaj e regjistrova shkollën e lartë të mjekësisë, drejtimin sanitar në Beograd dhe paralelisht kam studiuar në të dytë dhe

paralelisht i kam dhënë të gjitha provimet rregullisht. Pastaj kam mbaruar shkollën e lartë të mjekësisë në Beograd dhe jam punësuar kështu që unë nuk diplomova në frëngjisht, por jo për shkak se e humba. Nuk kam rënë në asnjë provim, sepse u ndala në një periudhë. Unë nuk mund të shkoja më tej për të përsosur gjuhën, por u ndala dhe ajo mbeti aty përndryshe kam mundur ta përfundoj edhe atë.

Natasa Govedarica: Por kryesisht keni jetuar në Prishtinë. Në Beograd keni ardhur sipas nevojës apo si ishte?

Olivera Budimir: Po, po. Unë kam ardhur këtu vetëm për të dhënë provimet dhe i kaloja provimet, por kam jetuar në Prishtinë.

Natasa Govedarica: E nëse do kishit krahasuar Beogradin dhe Prishtinën në atë kohë, a do mund të na thoni se si ishte jeta këtu si dhe atje dhe çka ju tërhoqi atje dhe çka këtu?

Olivera Budimir: Nuk kam pasur unë ndonjë nevojë për Beogradin. Unë e kam dashur vendin tim, Prishtinën time, mendoj timin. Nuk them timin, qyteti nuk është i askujt prej nesh por e përvetsojmë. Gjithkush ka tapi mbi diçka, aty ku kemi jetuar dhe ku kemi vënë rrënjët. Më kujtohet njëherë kur shkova për t'iu nënshtruar provimit apo ta paraqes, nuk e di, nuk më kujtohet. Dhe tani përderisa isha duke blerë një kartolinë në kioskë për ta dërguar në Prishtinë më pyet shitësja që ishte prapa në kioskë. Thotë, “Nga jeni ju?” Them, “Nga Prishtina.” “A ka vajza të tilla në Prishtinë a?” Mbase këtu në Beograd mendonim që ne “poshtë”² ishim diçka, të rënë nga një botë, nuk e di, nga nëntoka. Ne nuk kemi dalluar nga ata që ishin këtu. Dua të them, njëjtë është studiuar në Beograd dhe këtu. Kënga ishte në një nivel tjetër, atje kishim ne disa të tonat.

Vëllai im i cili ishte më i ri, ishte kitaristi kryesor [në bend], kitarist soloist në Prishtinë, i cili ka mbajtur mbrëmje muzikore me kumbarën dhe bendin e tij në tërë Kosovën. Kitara e parë elektrike, po mendoj kitarist kryesor. Nuk mendoj si kitara e parë e cila është sjellë “poshtë”, sepse edhe sot luan njëjtë, vetëm se nuk merret shumë në mënyrën e njëjtë, por “poshtë” kishte organizuar gjithandej. Sallat ishin plot, ishte... kishte edhe tarraca dhe gjithçka dhe e tëra ishte e mbushur, mendoj mirë jetohej, korzo ishte e shkëlqyeshme, në mes të Prishtinës çdo mbrëmje diku prej orës gjashtë, shtatë, deri në orën tetë, eventualisht tetë e tridhjetë tashmë shpërndaheshin. Aty shëtisnin shumë njerëz, aty ishin dy shtigje. Në njërën anë shëtisnin serbët, e në anën tjetër shëtisnin shqiptarët. Asnjëherë nuk shëtisnim bashkë. Kush e ka kurdisur këtë mund të... a ishte spontanisht apo e urdhëruar apo sido.

² Poshtë i kanë thënë Kosovës nga ana e Serbëve, pasi që qendra është konsideruar Beogradi, Serbia.

Aty kanë qëndruar normal, gjithkush kishte drurin e vet. Djemtë i shikonin vajzat, vajzat shëtisnin apo sido, por jemi shëtitur edhe paralelisht.

Natasa Govedarica: Cilat janë këto vite, Olivera?

Olivera Budimir: E pra, unë nuk e di se cilat vite ishin, ndoshta mesi i viteve tetëdhjetë, kur ndaluan së ekzistuari këto shëtitje në korzo. Mendoj që ka qenë kështu disi. Nuk jam e sigurt, por nuk më kujtohet, por e di që kishte çdo natë. Në atë kohë dilej herët dhe ktheheshim në shtëpi më herët dhe dihej koha se kur duhej të ishte në shtëpi. Unë kisha prindër shumë të rreptë. Unë duhej të isha në shtëpi deri në, kur shkoja në shkollë, shkollën e kisha shumë, e kisha afër. Shkollën e mesme të Mjekësisë, në fund, buzë qytetit. Unë në këmbë kam shkuar dhe në këmbë jam kthyer, sepse nuk kishte, kishte transport, por nuk ishte e sigurt që do të mbërrija me kohë apo sidoqoftë. Eh, e tillë është rinia. Ishte punë sekondash dhe unë duhesha, deri në orën shtatë zgjaste ora dhe deri në shtatë e pesëmbëdhjetë kemi pasur...sepse ne kishim përgjegjësi, nëse isha kujdestare [e klasës], që ne nxënësit të pastrojmë klasën, të gjitha t'i vëmë në vendin e vet. Mua më duhej të isha në shtëpi deri në ora shtatë e dyzet e pesë, por saktë në orën shtatë e dyzet e pesë. Nuk ishte fare afër, dhe vetëm në qoftë se nuk mbahej ndonjë orë, e humbnim ndonjë orë, atëherë shëtisja një xhiro në shpejtësi, mirëpo koha duhej të respektohej, duhej të vije herët në shtëpi, dhe më së voni në nëntë. Ky ishte maksimumi dhe unë në orën nëntë duhej të isha në shtëpi, në nëntë zero zero. Unë në orën nëntë duhej të isha në shtëpi. Deri sa kam fituar dhjetë zero zero ajo ishte o ho hoi {onomatopeike} nuk kishte asnjë mundësi të tejkalohet ajo. Nëna ime asnjëherë nuk hiqte dorë, “Gjatë ditës mund të shkosh ku të duash,” thoshte babai im, “por në mbrëmje duhet të jesh në shtëpi. Nuk është vendi, nuk është koha”.

Babai im e kuptoi situatën politike. Mbase gjithmonë ka folur me gjithë njerëzit tjerë sikur me të tij, sikur me veten, sepse ai i dinte gjuhët dhe as nuk e dallonin, ata e dinin se kush është kush dhe çka është çka. As ai kurrë nuk besonte në paqen që mbretëronte. Ai gjithmonë e dinte se do të vinte në këtë gjendje e cila edhe u bë më vonë dhe gjithmonë na thoshte, por asnjëherë askush nga ne nuk i besoi. Vëllezërit e mi dhe unë nuk besonim dhe gjithmonë kemi thënë, “Baba, na lejo të dalim deri në kohën e caktuar”. Kishte kaluar kjo kohë kush e di se kur. Për fat të keq doli që ai kishte pasur të drejtë sepse ai gjithmonë thoshte kur ne fitonim, kur ne krijonim, blinim, “Eja, eja, një ditë të gjitha do i leni dhe do largoheni”. Për fat të keq ndodhi ajo që ai e kishte thënë. Ai njëherë e pagoi vet sepse njëherë kishte lënë çdo gjë dhe ishte larguar dhe më nuk kishte besim në asgjë, mbase kishte edhe arsye pse ishte kështu. Thjeshtë besonte që ajo do ndodhte edhe pse ai gjithmonë kishte dashur dhe gjithmonë

donte të ishte këtu, miëpo nuk mundet njeriu të jetë i burgosur dhe të pres se çfarë do të ndodhë. Jeta duhet të vazhdojë. Por ai ka qenë i burgosur në atë kohën e tij dhe në atë që i kishte ndodhur atij.

Natasa Govedarica: Sa dini, në fakt, në lidhje me atë që i ka ndodhur atij në vitin '43, apo ka mbetur kjo pak a shumë në nivelin e [parandjenjës]?

Olivera Budimir: Shumë pak, dhe më vjen shumë keq për këtë. Tregonte si e kanë ndjekur natën dhe i është dashur të largohej nga shtëpia, ta liroj shtëpinë gjatë ditës së njëjtë, dhe të nesërmen të ikte me ca mobile bazike dhe të vogla. Një tren i cili kalonte nëpërmes Prishtinës, sepse hekurudhën e mbanin ballistët dhe më sa më kujtohet mua që ishte ashtu dhe pastaj i është dashur t'i paguaj aty një shumë të madhe parash dhe të ikte në shpejtësi për në Nish. Kështu edhe iki në Nish. Nuk donte të përzihej në kurrfarë ushtrie, nuk ishte lloji i tij, por ne nuk kishim... fatkeqësisht shumë gjëra na kanë mbetur të pathëna, mbase kjo është çmimi i rinisë. Për shumë gjëra nuk e kemi pyetur kurrë, nuk kishim nerva të dëgjonim për shumë gjëra dhe ai nuk donte të na i impononte ato. Thjeshtë e kemi lënë që kjo të kalojë ashtu siç ishte, por sigurisht që nuk e kishte të lehtë që të gjitha gjërat e tij t'i paketojë një mëngjes dhe të ikte dhe atë me vull. Pastaj ai në vitin '46, jo, '56 u martua në mërgim. Sepse kur është kthyer, ka provuar të kthehet dhe pastaj kishte borë në Prellacë dhe ai nuk arriti, kamioni në të cilën ai gjendej nuk arriti të kalonte dhe pastaj aty qëndroi në Banjën e Kurshumlisë dhe aty u martua me nënën time dhe pastaj lindi vëllau im dhe kështu ishte kjo histori.

Mirëpo ai gjithmonë dëshironte të kthehet në vendin e vet dhe u kthye, por gjithmonë e ka ditur që do të jetë sikurse edhe ka qenë. Dëshironte që megjithatë të qëndronte aty, sepse kudo që ka qenë, ka qenë edhe në Nish, pastaj edhe në Kurshumli, pas Banjës së Kurshumlisë dhe kështu. Ai ka qenë gjithandej, ai ishte një mjeshtër llamarist, mjeshtër i klasit të parë. Në atë kohë kërkoheshin mjeshtërtr pasi që nuk kishte asgjë, asgjë nuk punonte, as fabrikat, as shumë gjëra tjera, por gjithë kjo ka lënë një gjurmë të thellë. Ai ishte gjithandej, nuk kishte rrënjë askund. Atë e quanin *klonfer*³ askush nuk e dinte emrin. Askush nuk do ta dinte tani se kush ka qenë ai Sllobodani i cili ishte atje, i cili jetonte në mesin e tyre. Ai është i vetmi *klonfer*, shoqërohej me popullsinë vendase, ai ishte me ta gjithë kohën, fliste për disa nga përvojat e tij, por ai kurrë nuk ishte njëri prej tyre. Në të vërtetë ai përsëri donte të kthehej prapa, përveç që ishim të vendosur me qira në një shtëpizë sociale deri sa kemi arritur të krijojmë përsëri sepse ai nuk kishte më asgjë të vetën. Pronën e tij nuk ka mundur kurrë ta riprononte sepse ligji i vitit '48 i kufizonte të gjithë ata që nuk ishin kthyer deri në vitin '48, nuk mund të kërkonin pronën e tyre. Atë e kufizoi në mënyrë që ai nuk e kishte më të drejtën të kërkonte pronën e tij.

³ Serbisht: mjeshtër që punon me llamarinë; kolokial. teneqexhi.

Natasa Govedarica: A e dinit ju se ku gjendej ajo shtëpi?

Olivera Budimir: Po, kam shkuar për ta parë. Ai asnjëherë nuk donte të na dërgonte andej. Kam shkuar për ta parë dhe e kam shikuar ashtu nga largësia. Do të thotë, unë nuk kam asnjë ndjenjë për të përveç asaj që më ka treguar babai, por ai nuk ka folur për këtë, shumë pak fliste. Njëherë shkova për të parë fushat e tij në afërsi të qytetit, një hektar tokë, e cila tani është me vlerë të madhe ndërsa ne nuk e kemi tapinë, mendoj që kanë mbetur në bodrum, për më tepër as ne fëmijët nuk ishim të interesuar të dinim se në emër të kujt ishte tapija, sepse në atë kohë nuk barteshin prej një gjenerate menjëherë në tjetrën. Kurse mbiemrat kishin ndryshuar atje, nipi kishte marrë mbiemrin nga emri i gjyshit dhe gjithmonë kështu, kështu që e vështirë ishte.

Unë kam provuar të gjej diçka, sepse kam punuar në kuvendin e qytetit, jam munduar të hulumtoj se kush e posedon, ku është tapia, çfarë kishte ndodhur me të. Sepse unë nuk mund ta kërkoja me atë emër për shkak se babai im është Aksiq, kurse babai i tij është Nedeljković, pasi që gjyshi i babait tim quhej Aksa dhe mbiemri është marrë nga gjyshi, kështu ishte. Babai i tij vdiq kur ai ishte, babai im ishte gjashtë vjeç. I vogël ishte, nëna ishte qytetare, prishtinase. Ato ishin zonja që u pëlqente të pinin kafe, u pëlqente procesi i pirjes së kafes, i krijimit të marrëdhënieve dhe ngjashëm, ato nuk dinin disa nga ato punët e thashethemeve, taksat, këtë, atë, thjeshtë ishte kështu. Kështu ishte kjo, për ne dhe për familjen time ishte e humbur, kjo ishte më e pakta. Ne jemi mësuar të jetojmë pa të, gjithmonë kemi jetuar ashtu.

Natasa Govedarica: Tani më falni për këtë dalje nga tema, por ju ishit diku në kohën e studimeve, rreth kohës kur e keni mbaruar shkollën në Beograd dhe ju jeni, në qoftë se kam kuptuar si duhet, jeni kthyer në Prishtinë për të punuar?!

Olivera Budimir: Unë asnjëherë nuk jam larguar nga Prishtina.

Natasa Govedarica: E kjo.

Olivera Budimir: Unë vetëm kam studiuar këtu dhe atje, në mënyrë paralele. Pastaj u punësova në kuvendin e qytetit të Prishtinës dhe vazhdova të jetoj dhe të kem një punë të mirë në kuvendin e qytetit.

Natasa Govedarica: Saktësisht cila ishte puna juaj?

Olivera Budimir: Unë kam punuar si bashkëpunëtore e lartë në Sekretariatit e shëndetësisë, veteranëve, shërbimi social dhe mbrojtjen e fëmijëve, kështu që unë jam ndier mirë këtu, mendoj

vërtetë mirë. Puna shtetërore siç është thënë. Në atë kohë, ishte shumë mirë që të kishe një punë shtetërore, punë tjera edhe ashtu nuk kishte, kështu ishte. Mirë e kisha, kisha lirinë time, ligji ishte i vetmi autoritet, ishte mirë. Kjo është arsyeja pse unë kam mbajtur atë punë, dhe pastaj kam studiuar drejtësinë dhe e kam bërë thjeshtë sepse kisha hapësirë dhe studioja dhe erdha deri të viti i tretë dhe më pas u martova dhe kur kam vendosur ta vazhdoj filloi lufta dhe ishte vonë ta përfundoj atë etj, etj.

Natasa Govedarica: Do të thotë, ju kishit filluar të punoni dhe në atë kohë ju ende ishit në shtëpinë e prindërve, apo jo?

Olivera Budimir: Po, unë isha ende e pamartuar kur kam filluar të punoj, e pastaj jam martuar. Burri im ishte... ai nuk është me origjinë nga Kosova, edhe pse ai ka lindur në Kosovë. Ai është me origjinë nga Lika, do të thotë Likas. Të parët e tij ishin zhvendosur, gjyshërit e tij, prindërit e tij ishin të vogël, kur Mbreti Aleksandër popullonte Kosovën me serbë, sepse në atë kohë përsëri vërehej një mungesë sepse njëjtë shkaku i ikjeve, emigrimit, mendoj unë, nuk kam njohuri për atë periudhë, normalisht që nuk e di, e di vetëm historikisht, por ata jetonin atje, ai përfundoi shkollimin dhe ka punuar. Kur e takova ai ishte kreu i zyrës së udhëtarëve në Prishtinë.

Natasa Govedarica: Si jeni takuar?

Olivera Budimir: Mua më pëlqen të udhëtoj, kurse ai organizonte udhëtime. Dhe unë... ai organizonte një udhëtim të bukur për në Rusi. Ai ishte profesionist dhe të gjitha udhëtimet e tij ishin të bukura. Udhëtimet e tij ishin të menduara në mënyrë të veçantë sepse të gjithë insistonin që të udhëtojnë nëse edhe ai udhëton me ta. Sepse ata e dinin që ai gjithmonë kishte një *joker*⁴ në mangën e tij dhe që gjithmonë përveç marrëveshjes bazë, do u mundësojë diçka të bukur. Ishte me të vërtetë kënaqësi të udhëtosh me të. Kështu, në atë kohë ishin dy grupe dhe unë u regjistrova për njërin udhëtim, njëjtë për Rusi. Ishte Moska, Leningradi, Kievi e kështu me radhë, por arriti të më bind që të mos shkoj me grupin e parë por me grupin e radhës. Unë nuk e dija që në grupin tjetër ai ishte udhëheqësi, ai e udhëheqte dhe duhej të ishte aty. Në rregull, udhëtuam, e gjitha ishte e përkryer. Unë përsëri shoqërohesha me dikë tjetër që e njoftova aty dhe ishte një ëndërr e imja ta shihja Moskën, ta shihja Rusinë. Edhe sot është tërheqëse për mua.

Natasa Govedarica: Por ky nuk ishte udhëtimi i parë jashtë vendit?

Olivera Budimir: Jo, por një nga më të mëdhenjtë, udhëtimi i parë i madh ishte ky. Atëherë ne jemi, ai organizonte shumë bukur përveç që ditën e fundit në mëngjes më thirri para se të nisemi për në rrugë,

⁴ Anglisht: *joker*, letra me fat, që ofron mundësi të shumta në lojra me letra.

ai më thirri dhe më pyeti, “A është gjithçka në rregull?” Në fakt, në mbrëmje përpara se të udhëtonim, sepse në mbrëmje kemi udhëtuar. Ashtu, “Po, gjithçka në rregull.” “Në rregull, shihemi në orën pesë.” Për shkak se autobusi është dashur të niset nga Prishtina për në Beograd dhe nga Beogradi të fluturojmë me aeroplan për më tej. Unë në autobus e kuptova që nuk do të udhëtohet për në Kiev. Unë desha atij t’i bëja problem dhe ta kthej gjysmën e autobusit nga Beogradi. “Ti nuk ke të drejtë të mos na njoftosh që ka ndryshim të programit. Nëse tashmë ka ndryshim të programit unë kam të drejtë të pranoj ose jo atë program”. Mirëpo, normalisht nuk e bëra, por kam qenë shumë e zemëruar dhe atij i është dashur të më martoj dhe të ma shpaguaj me vite këtë Kiev. Por nuk e kam parë Kievin as më vonë, por kjo ishte në fakt atëherë kur ndodhi Çernobili dhe për atë arsye është anuluar dhe nuk shkuam. Në atë kohë ajo nuk dihej ende. Ne kemi shkuar disa ditë pasi që kishte ndodhur Çernobili, por ende nuk dihej, ende e mbanin fshehtësi.

Natasa Govedarica: Do të thotë nga mesi i viteve tetëdhjetë, është koha kur ju në fakt njoftoheni?

Olivera Budimir: '86.

Natasa Govedarica: Dhe si shkoi më tej?

Olivera Budimir: Tani atje, mendoj ishte në Moskë, po. Duke qenë se me të vërtetë ishte intensive, programi ishte shumë i mirë dhe shoqëria ishte e mirë, kemi shëtitur gjatë ditës, kemi vizituar. Moska dhe Leningradi janë me të vërtetë qytete të mëdha, nuk mund të vizitohen. Gjithë ditën jemi sorollatur, vizitonim me cicëron ose pa cicëron por në mbrëmje kemi shkuar në disko bare për vallëzime, kështu që ishte intensive. Këto dhjetë ditë ishin shumë intensive, nga mëngjesi deri në mbrëmje. Ne të dy takoheshim vetëm kalimthi me njëri-tjetrin, qoftë kur ndodhte diçka ai të vinte për të vizituar, për të parë nëse çdo gjë ishte në rregull, në mëngjes apo darkë apo kurdo... çdokund kishim hotele të shkëlqyera apo kur kishte ndonjë program, vizitë, atëherë ndodhte që edhe ne të jemi aty, ishim numër, sepse ai ishte tepër profesionist dhe i vërente të gjitha, por e bënte në mënyrë diskrete pa asnjë ndërhyrje në ndonjë gjë.

Kështu, një mbrëmje kishte muzikë, vallëzim dhe vallëzonim të gjithë dhe ai më zgjodhi mua për të vallëzuar dhe e vallëzuam vetëm gjysmën e këngës. Çfarë simbolike ka jeta, vetëm gjysmën, u ndal muzika dhe u ndezën dritat. Pastaj u ndamë disi dhe nuk vallëzuam më ose unë kalova tek tavolina tjetër me shoqëri dhe kjo ishte e tëra. Se si ka një lloj... [simbolike] siç thotë Ivo Andriq, “Shenjat përgjatë rrugës.” Pastaj kur u kthyem, ai filloi të më thërriste, më pyeste, “Si të pëlqeu, a ke pushuar?” Dhe pyetje të ngjashme, megjithatë unë nuk kam treguar kurrfarë interesimi dhe nuk kuptova si një

lloj interesimi. Gjithsesi me kohë gjërat u zhvilluan në një tjetër drejtim dhe kështu në janar pas nëntëdhjetë muajsh u martuam.

Ishte befasuese për gjithë shoqërinë tonë me të cilën shoqëroheshim në atë kohë, sepse asnjëri nuk e dinte, asnjëri nuk e priste, as unë. Por ia doli. Njëherë një gazetare më pyeti se si e arriti, çfarë ishte ajo me të cilën ta fitoi zemrën? Unë u zura ngushtë duke qenë sepse me duhej të zgjedhja vetëm një gjë në një mori gjërash, por, e di, mu kujtua mirë dhe mendoj që kjo ishte arsyeja. Ai është dikush, mashkull që besonte në veten e tij. Dinte se si ta marrë atë që dëshironte. Ka shumë rëndësi besimi në vetëvete, dhe jo të mendosh, “Ajo është kështu, lërë, nuk ka gjasa!” Por ai besonte në veten e tij dhe më bëri për vete. Disi ai arriti edhe pse unë nuk i besoja as vetës sime dhe as atij, por ai ia arriti të më binde në besimin e tij, dhe pastaj u martuam dhe kemi pasur një martesë të bukur, pa mosmarrëveshje, kemi udhëtuar.

Unë nuk kisha kurrfarë kufizimesh të caktuara. Unë nuk e di se çfarë është dallimi nga ajo që unë kam qenë, pasi që kam pasur një liri absolute për të vepruar. Ne e dimë se çfarë është liria për një grua të martuar, natyrisht. A do të shkoj me një mike, për të udhëtuar, të shoqërohem, të dalë në mbrëmje, nëse do të më vinte ndonjë mik apo mike apo dikush tjetër në shtëpi. Kisha liri absolute, një njeri i përbotshëm që unë nuk e dija, absolutisht nuk e njihja si të tillë. Nuk e dija që kjo ekzistonte, por ja që ekziston. Për të nuk kishte rëndësi askush, as se kush cilit nacionalitet i përket, ai e bëri punën e tij në mënyrë profesionale. Bashkëpunonte me të gjithë, të gjithë i kishte miq, të gjithë në qytet e donin dhe kishin vetëm fjalë të mira dhe lavdata. Kështu që nëse unë do thosha diçka të shëmtuar, do ishte e keqe nga ana ime. Nuk do kisha asgjë për të thënë, ishte një jetë e mirë.

Natasa Govedarica: Deri kur ishte jeta e bukur?

Olivera Budimir: Ishte deri në vitin '99 kur ndodhi ky ferr prej luftës. Ne kemi, unë atëherë kam insistuar që ne të kemi një fëmijë, sepse unë tashmë kisha pasur një përpjekje të pasuksesshme, prej pakujdesisë sime, mirëpo kisha një traumë të madhe psikologjike të cilën nuk kam arritur ta tejkaloj dhe pastaj kam insistuar të kemi një fëmijë. Ai nuk e diskutonte këtë çështje dhe gjithnjë pyetej, “Pse po insiston nëse unë nuk bëj pyetje?” Unë gjithmonë e pyesja vetën, “E kush je ti të bësh pyetje e unë jo?” Unë nuk po kërkoj fajtor, unë dua rezultate. Kinse meshkujt kanë gjithmonë të drejtë të bëjnë pyetje, gratë, çka tash, dhe nëse ata pajtohen ne nuk kemi çfarë të pyesim. Por, unë nuk jam ai tip.

Unë jam dikush që gjithmonë ka qenë vetja dhe gjithmonë e kam ditur se çfarë dua, dhe kam provuar ta shtyej [procesin] vetëm të ndodhë, të mos heqim dorë pa u përpjekjekur, dhe të bëjë të mundshmën përbrenda mundësive, në atë moment për ne. Nuk ka qenë e thjeshtë, sepse nuk është e

thjeshtë të merresh me meshkuj, me egon e tyre dhe gjëra të tilla, por unë arrita ta bëjë këtë. E detyrova që megjithatë të pranojë një trajtim për ta tejkaluar këtë pengesë edhe pse mjekët pohonin që gjithçka ishte në rregull, por megjithatë nëse deri më tani nuk ka ndodhur asgjë, ekziston ndonjë problem në kokë, por edhe ai është problem. Duhet të gjendej një zgjidhje, dhe kjo ndodhi në prag të luftës dhe tani pasi filloi që të shembej toka dhe të ndodhin disa gjëra tjera, unë kisha, isha në botën time, ne ishim në botën tonë, unë kam menduar në lidhje me këtë, dhe kam menduar që kjo, ajo kriza apo eskalimi politik do të zgjidhej, që megjithatë nuk u zgjidh.

Gjithsesi ky është shtet, Serbia është shteti dhe që do të ndodhnin gjëra të tilla dhe atë diçka e ngjashme... mendoja që, epokat kohore, epokat e hershme kishin një kuptim, që ne jemi një shoqëri e civilizuar, që disa gjëra nuk mund të ndodhin në shekullin XX, mendoja unë. Fatkeqësisht, e kisha gabim dhe kështu ndodhi, lufta dhe unë, bashkëshorti im dhe unë e kaluam gjithë luftën në qytet. Ne ishim të angazhuar gjithë kohën, ai në vendin e tij të punës dhe vetëm dy-tre ditët e fundit jemi larguar nga qyteti dhe atë me vetë dëshirë dhe gjithë kohën ishim aty. [Ne] nuk ishim kurrë, as familja ime, as familja e tij, kurrëfarë ekstremistësh. Askund nuk jemi përzier, nuk kishte asnjë arsye që ne të iknim apo ngjashëm, ne mendonim që nuk ka arsye. Kështu qëndruam, qëndruam në Prishtinë, ishim në qytet gjithë kohën.

Pastaj ndodhi, ndodhi që bota kishte vendosur ndryshe, dhe filluan bombardimet të cilat kanë qenë të ashpra dhe kanë eskaluar. Ne kryesisht kemi qëndruar në banesën tonë, nuk shkonim as në bodrum. Ishim gjithsej dy-tre ditët e para dhe pastaj vendosëm të kthehemi në banesën tonë dhe aty e kaluam gjithë kohën e bombardimeve. Megjithatë, kur gjithë kjo përfundoi, kur...sepse në tavolinën e pushtetit, siç thoshte babai im, vetëm tani e kuptoj, që megjithatë e gjitha përfundoi në tavolinën e pushtetit, u nënshkrua Marrëveshja e Kumanovës e cila nuk është e mirë por nuk kishte, e di që nuk kishte zgjedhje tjetër, e vetmja alternativë ishte që e tëra mos të shkatërrohej më tej. Por, a mund të thuhet që unë e di, nuk e di, por kështu mendoj.

E pastaj ndodhi ferri i vërtetë në Prishtinë, një ferr i vërtetë. Para kësaj ishte ferr sepse nuk dihej kush do ta priste agimin, sepse gjatë gjithë kohës fluturonin aeroplanët, bubullonte, gjatë gjithë kohës kishte rënie të bombave në qytet dhe jashtë qytetit dhe sipër dhe bubullonte edhe ditën edhe natën, nuk kishte të ndalur. Por unë gjatë gjithë kohës shkoja e rregulluar, e grimuar në punë sikur të isha duke shkuar në ballo, sikur çdo herë tjetër. Kështu e ndjeja nevojën dhe kështu veprova, sikur çdo gjë të ishte normale. Megjithatë, pas Marrëveshjes së Kumanovës filloi ferri i vërtetë, sepse prej një asgjëje nuk e di prej nga, na u vërsul një forcë e errët, u vërsulën njerëzit nga të gjitha anët, disa fytyra të panjohura sikur të kishin ardhur nga nëntoka. Po supozoj ishin nga Shqipëria, Maqedonia, nga

fshatrat, nga të gjitha anët u mbërthyem, rrëmbime, vrasje këtej, masakrime andej. U bë një kaos i madh.

Unë deri në ditën e fundit, deri me 29 qershor isha në qytet dhe mendoj që pas nënshkrimit, do të thotë, prej 10 deri me 29 qershor ishte ajo periudha më e keqe, ka qenë vërtete shumë e ashpër, por ai nuk besonte që do të ndodhte, që ne do duhej të ikim. Thoshte, “Ti je duke e zmadhuar, ti vetëm po shkakton panik.” Megjithatë, ishte evidente që nuk përballohej dot dhe pastaj vendosëm, kur unë arrita ta bind të nisemi, të ikim, edhe vëllai im edhe babai im edhe kunata, fëmijët e tij, ne na duhej të iknim dhe t’i lenim të gjitha ashtu siç ishin. Para kësaj kur erdha njëherë në banesën time, sepse ne kishim kaluar të jetojmë në banesën e nënës, sepse ajo ishte matanë rrugës sikur kjo ndërtesa këtu {tregon me dorë}, thjeshtë një rrugë i ndante dhe aty matanë rrugës ishte i vendosur KFOR-i. Mendonim, pasi aty dikur ishte e vendosur Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë (MUP)⁵, dhe mendonim që aty jemi të sigurt sepse vetëm rruga na ndante nga KFOR-i dhe e shihnim atë nga dritarja. Prandaj u zhvendosem aty, kurse banesa jonë ishte në pjesën tjetër ku kishte shumë shqiptarë në rrethinë.

Edhe pse në ndërtesën tonë nuk kishte njëri dhe as nuk ishte thyer ndonjë banesë, unë e kisha mbyllur atë. Vetëm ne të dy qëndruam në banesë gjatë luftës. Unë e kisha mbyllur gjithë ndërtesën dhe të gjitha banesat janë ruajtur dhe askujt nuk i ka munguar asgjë, të gjitha mbetën siç kishin qenë pavarësisht nëse ata ishin serb, shqiptar apo turq. Kishte turq në ndërtesën tonë, e gjithë kjo ishte në rregull. Por, kur kjo ndodhi, ne megjithatë kaluam andej sepse në rrethinë nuk ishte mjedis i sigurt. Nuk dinim kush ishte aty. Ne e dinim se kush jemi ne, por nuk dinim se kush ishte në rrethinën tonë.

Një ditë shkova te banesa ime me vëllaun tim dhe e pash që në derë shkruante me shkronja të mëdha, “UÇK”, me stilolaps të kuq. Unë u shtanga, çfarë të bëjë tani? Megjithatë, guximshëm u mundova të hyj, e hapa derën dhe hyra. Aty kanë qenë një... më thoshte që është fqinj i yni shqiptar dhe një grua e tjetrit fqinj. Unë mendoj që ata ishin duke u fjalosur se kush do të zптоjë banesën time dhe ishin duke vendosur. Sepse ata ishin duke u fjalosur ndërmjet vete se kush do të hynte. Unë hyna dhe shikova se çfarë po ndodhte, mundohem të mendoj shpejtë dhe dëgjoj që edhe në banesën tjetër janë duke u fjalosur njëjtë rreth banesës, por në gjuhën shqipe. Këtë që e thash, harrova ta përmendi, pse babai im thoshte, “Unë nuk e kuptoj këtë gjuhën shqipe që ju e mësoni në shkollë, kur them gjuhën shqipe dhe *šiptarski*”. Këta ishin duke u fjalosur në gjuhën *šiptarski* dhe jo në atë shqipe. Gjuha shqipe është gjuha letrare, kurse popullsia e flet gjuhën *šiptarski*, burimore, atë që gjithmonë e kanë përdorur kur kanë

⁵ Ministria e Punëve të Brendshme, *Ministarstvo Unutrasnjih Poslova (MUP)*

folur mes veti. Do të thotë, ka dallime të mëdha, nuk është e njëjtë. Ata as nuk kuptohen kur flasin. Si për shembull, ne jemi të afërt me kroatët, sllovenët, për shembull, ashtu është dallimi.

Edha të tjerët në derën ngjitur fjaloseshin, dëgjoj që po ndodh diçka. Tani nuk e dija se si do dalim nga banesa jonë, përderisa veturën e kemi para ndërtesës. Mund të na thyejnë veturën. Tani unë mendoja si do ia bëjë, mundohem që pa u shqetësuar t'i shërbej me nga një pije, e marr pijen për ta vënë në gotë, ishte alkool. Nuk e kam idenë, mendoj shpejtë, truri më punon tre qind në orë, unë po i buzëqeshem dhe ndërkohë mendoj si do dalim nga banesa pa e vrarë vëllaun, hajt mua, banesa është e imja por ai ishte aty me mua. Kur dolëm, në një moment vëreja, dëgjova qetësinë e krijuar në hyrjen e dytë, sepse më kishte mbërthyer fqinji në fjalosjen e tij se kush do mbetet me banesën, ata të ardhshmit. Unë vetëm e rrëmbeva një telefon të vjetër që e kisha afër, e kam shkukur nga muri, valixhet ishin afër derës dhe i thashë vëllaun, "Merri!" Ai i kapi ato dhe unë i hodha çelësat në tavolinë, por papritur e kam befasuar edhe veten i kam thënë fqinjit tim, "Të uroj fat deri sa unë të kthehem!" Dhe dola nga dera. Na është dashur që të veprojmë si të habitur që të mos vriteshim nga ata, apo të na befasonin me ndonjë veprim.

Pastaj ne ia mësymë veturës dhe ikëm me nxitim. Ky ishte vendim sekondash dhe të gjitha në banesë mbetën siç kishin qenë. Përse ta thyente derën, e lash çelësin në tavolinë. Pastaj kaluam tek nëna e Rades, ajo tashmë kishte shkuar tek e bija e saj në Serbi. Ne kemi shkuar poshtë. Njëri që i thoshte vetës kojshi, tregonte se si disa serb e kanë dhunuar një vajzë në njërin nga shtretërit në shtëpinë e tij. Duke qenë se ai ishte në Maqedoni gjatë bombardimeve, mendoja, "Si mund ta dish se çka ka ndodhur në shtratin tënd dhe shtëpinë tënde kur nuk ke qenë aty?" Nuk ka kuptim, gjepura, por unë bëja sikur nuk i dëgjoja ato pasi kam dëgjuar edhe shumë gjëra tjera pas asaj. Sepse unë nuk mund të di se çfarë ka ndodhur në banesën time edhe atëherë kur nuk jam aty. Sepse edhe kur të kthehem edhe po ta shikoj nuk mund ta shoh. Nuk mund ta di çfarë ka ndodhur. Askush nuk mund të ma thotë këtë. Atë person nuk e kisha parë kurrë më herët. Ai ishte, thoshte që ishte nga shtëpia afër ndërtesës tonë ku ne jetonim, që gjendej një shtëpi dhe ai me gjasë kishte qenë aty. Unë kurrë më parë nuk e kisha pa atë.

Prona nuk është e rëndësishme, ne jemi të rëndësishëm dhe jemi larguar. Bashkëshorti im duhej të vinte pastaj. Ne qëndruam disa ditë në banesën tonë. Mendoj që unë e kam vizituar edhe njëherë, ndoshta edhe jo. Nuk më kujtohet se çfarë ka ndodhur në atë kohë, nuk e di. Mirëpo, të gjitha shtëpitë ishin mbushur me njerëz, gjithçka që ishte brenda banesës, mbeti aty. Ne në atë kohë e kishim blerë edhe një banesë tjetër. Bashkëshorti im në prag të luftës bleu një banesë të re për tu zhvendosur. Megjithatë, ne nuk u zhvendosëm në atë banesë dhe ai mbeti ashtu. E vetmja gjë për të cilën u

pajtuam, unë megjithatë insistoja që të largoheshim, nuk kishim më çfarë të kërkonim, të largoheshim, vetëm kokën mund ta shpëtojmë, nëse e shpëtojmë. Sepse iknin nëpërmjet Merdares, ishte e rrezikshme dhe tashmë vrisnin njerëz dhe ndodhte gjithçka, kanë rrëmbyer, janë zhdukur dhe qëllonin në karvanë dhe kamionë. Nuk na ndjekte askush, askush nuk e ndjekte askënd. Ishte me të vërtetë një çmendë.

Ka shumë për tu treguar. Unë kam parë edhe para kësaj, edhe para bombardimeve kishte shtëpi të djegura me çati të rrënuara. Nuk kishte shumë, por kishte raste. Në çdo popull ka edhe njerëz të lig, nuk mundemi ne, askush nuk është i përkryer, por pas kësaj filloi ferri, plaçkitje e tillë, vrasje të tilla, trokitje në dyer. Unë kam përjetuar në atë banesën tjetër, kam shkuar në atë të riun. Më trokisnin në derë, “Hape nuk të bëjmë gjë!” kurse unë nuk doja ta hapja. Derën mund ta thyente me këmbë dhe të futej përderisa unë isha brenda. Pastaj e thirra KFOR-in. Unë bërtisja, në atë kohë nuk kishte celularë, por unë e pash një grua nga ballkoni e cila ishte banore në hyrjen tjetër afër ndërtesës tonë, iu lajmërova dhe shkoi menjëherë dhe i solli këta të KFOR-it. Erdhën ata, ata ishin nëpër të gjithë korridorin e ndërtesës, dhe i gjithë korridori ishte me *šiptar*. I gjithë korridori ishte i mbushur, edhe shkallët, uleshin dhe shikonin se kush do hynte i pari në ndonjë banesë. Se kush i informoi ata apo si dëgjuan që KFOR-i ishte duke ardhur, askush nuk mbeti, as edhe një. Të gjithë u shpërndanë. Unë shkova me ta. Unë isha shumë e pamatur dhe shkova me ta, ata ishin të armatosur dhe bashkërisht me ta nga banesa në banesë, por askund nuk ishin. Ku u zhdukën gjithë ata njerëz?

Kështu e pash që e morën njërin që ta largojnë nga aty, jo për ta arrestuar, kur ai kthehet kah unë, e ngriti bluzën dhe ma tregoi bombën. Unë isha në ballkon. Unë i them, “Unë vet do e vë bombën këtu, ti guxo të hysh pas meje. Në banesën time, kur unë të dalë vet do e vë bombën.” E kështu ne flisnim për bomba në prezencë të KFOR-it. Natyrisht, unë jam larguar pas kësaj sepse nuk kishte më kuptim të qëndroje aty. Prisja unë, sepse unë gjatë gjithë kohës ngisja makinën, vizitoja familjen time, e gjithë kjo ishte një çmenduri e pamenduar. Mund të ma vënin një bombë nën makinë dhe unë të fluturoja, absolutisht nuk e kam menduar, por mbase askush nuk e mendoi dhe askush nuk ishte i mençur. Kujtdo që i ndodhi diçka i ndodhi dhe kaq. Ose të gjithë kanë menduar që janë më të mençur dhe janë marrë vesh me Zotin që asgjë nuk do i ndodhte. Kështu që në fund ne, unë arrita ta bind Raden dhe i thashë, “Nesër duhet të largohemi. Nuk ka zgjidhje tjetër”. Askush nuk na ka përcjellë, askush nuk e përcillte askënd, KFOR-i nëpër Merdare, të gjithë shkonin me përgjegjësi mbi veten e tyre, secilit mund t’i ndodhte gjithçka. Kështu ne vendosëm të largoheshim dhe derisa u nisëm ishte një çmenduri e vërtetë.

Kur jemi nisur herët në mëngjes, [i parmendoj] në çast ata vetëm shfaqën aty rreth makinës dhe thjeshtë e bllokojnë atë, e vrasin dhe e heqin personin nga makina, hyjnë në makinë, i kanë edhe çelësat aty dhe largohen. Ose në banesë, tek fqinji jonë, ata iu vërsulen banesës, trokitën dhe ai e hapi derën, u turrën në banesë, ia morën celularin, nuk ishte celular, ishte një i llojit GPS apo ku ta di unë. Nuk ishte GPS, ishte diçka nuk me kujtohet tani, një lloj telefoni. Ia morën, nuk e di, të gjitha gjërat me vlerë i kapën dhe atë e urdhëruan që deri në orën gjashtë pasdite të largohej nga banesa dhe të mos gjendej andej. Ia morën edhe çelësat e makinës, sepse kjo ishte më e sigurt, sepse pa çelësa nuk mund ta ngiste atë. Kur dikush gjendet në makinë, vetëm e ç'blllokojnë e marrin atë apo e vrasin personin. Unë i kam parë këto, shihja gjak në rrugë. Më kujtohet kur, nuk me kujtohet se kush, por e kanë vrarë dikë, ishin tre persona. Kur pash që i kanë mbytur në makinë, pastaj e kanë sjellë makinën. Mbase KFOR-i i ka sjellë në qendër, dhe unë i kam parë, vetëm atëherë kemi vendosur, unë e binda që të niseshim.

Vëllau im, babai dhe kunata, unë i kisha në makinën time mbesën dhe njërin nip. Njëri prej vëllezërve bashkë me kunatën nuk donte të largohej. Ata mbetën në banesën e tyre kurse njëri vëlla me babën [e gruas] e tij të moshuar, u nisëm. Do të thotë, dy makina dhe një ishte para nesh, kështu që do bëhej ajo që do Zoti. Unë ngisja shpejt Mitsubishin, kurse vëllau ngiste, vëllau ngiste Jugo dhe unë shikoja në pasqyrë se çfarë ndodhte me të. Sepse në momentin që nuk e shihja më kaplonte paniku në kuptimin se, ku mbeti dhe çfarë i ndodhi? Pastaj ndalesha për pak kohë, deri kam arritur në Merdare, pike gjaku nuk kishte në mua.

Sidoqoftë, e kaluam disi, mbijetuam, kurse Rade im në moment të fundit kur po hynim në veturë më tha, “Unë nuk do të vij.” Tha, “Unë nuk do të vij, unë do të qëndroj. Mua askush nuk më kërkon, çfarë i kam bërë kujt?” Nuk kishte më kohë, unë nuk mund të prisja më shumë sepse më priste familja ime, unë prisja që ai të nisej dhe kështu të gjithë u bllokuam. Kështu unë vendosa që megjithatë të nisem. Unë u nisa, kurse ai mbeti. Vëllau im është kthyer dhe ka qëndruar me të. Qëndroi afër banesës dhe shtëpisë që e kishte, shtëpisë së babait ku ata kanë jetuar, vëllau, kunata dhe babai, sepse nëna kishte vdekur më herët dhe banesën e saj ai e kishte veç, mirëpo ai përsëri jetoi me Raden në banesën e nënës së Rades në mënyrë që të qëndronin së bashku. Aty edhe qëndruan.

Vëllau ende punonte në termocentral. Duke qenë se ishte njëri prej tyre, aty kishte termocentrale. Më sa më kujtohet, kishte rreth shtatë mijë punëtor, nëse jo më tepër. Prej atij numri nuk e di se sa ishin serb. Kurse prej gjithë atyre serbëve që ishin aty, sepse pjesa dërmuese ishin shqiptar, prej gjithë atij numri të serbëve katërmëdhjetë janë lejuar që të hynë në kompleksin e termocentralit, pra ishin në regjistër, njëri prej tyre ishte edhe vëllau im. Termocentrali gjendej në Kastriot, rreth tremdhjetë

kilometra larg Prishtinës. I duhej të shkonte deri në termocentral me autobus, ku të gjithë përreth tij ishin *šiptar* dhe vetëm ai ishte i vetëm aty. Tani, pyetja është, se cili prej tyre ishte ekstremist. Megjithatë, ai ka shkuar në punë gjatë gjithë korrikut. “Përse të jap dorëheqje? Dorëheqja nuk jepet kështu.” Mbase të gjitha do të rregullohen dhe do mbetet në punë, sepse ka edhe fëmijë.

Sidoqoftë, pastaj shkoi në Bllacë një fundjavë, edhe Rade duhej të shkonte me të. Unë e prisja Raden, ne duhej të niseshim me datën 2 gusht, për në Shën Ilija, në Kopaonik tek motra e Rades, sepse e festojnë festën dhe pastaj të nisemi për në Beograd apo ngjashëm. Në mbrëmjen e 1 gushtit dëgjohem më të, ai më telefonoi rreth orës 11:30 që ishte e pazakonshme të më thërriste aq vonë. “Çfarë bënë? Si je?” I them, “Pse nuk ke ardhur ende?” Sepse vëllau tashme kishte ardhur kurse ky jo, sepse unë e prisja. “Do t’nisem këto ditë, por ta kesh parasysh që do kthehem përsëri.” Unë i them, “Po mirë, eja njëherë, eja njëherë e ta shohim pastaj se si do të kthehesh, por njëherë eja që të të shoh që ke ardhur njëherë.” “Mirë, do të vij, do të vij. Mos u brengos! Kam si të vij unë. Kemi disa autobus të “Putnikut” që i kemi fshehur në Graçanicë kështu që do vij me atë autobus.” I them unë, “Si do t’vish ti kur nuk ke as veturë, nuk ke asgjë.” Sepse makinat ishin tek unë, edhe njëra edhe tjetra. “Makina jonë është tek unë.” Unë nuk mund t’i thoja vëllaut tim të shkonte ta merrte atë pasi që edhe për të ishte e rrezikshme. Nuk mund ta ekspozoj atë para rrezikut. Nëse ai e kishte vendosur vetë, dhe e ka vendosur, do të vijë, nëse nuk vjen nuk mund t’i them shko sjelle Raden, nuk kam zemër. [Ai] Më thoshte, “Mos u brengos, unë do të vij gjithsesi, i kam mënyrat e mija.” “Mirë.” Kjo ka ndodhur me 1 gusht dhe me 2 gusht nuk kam dëgjuar më për të.

Vëllau im ka shkuar përsëri në Prishtinë dhe e ka parë që nuk gjendej në banesë. Vëllau im e kishte edhe çelësin e banesë të nënës së Rades dhe kishte hyrë dhe në atë banesë, por Rade nuk ishte aty. Por ai e dinte, Rade ishte i tillë, gjithmonë sorollatej, obzervonte, shkonte andej – këndej, dhe e pa që ai nuk ishte aty, mirë. Në mbrëmje kur ai është shtrirë për të fjetur, e kishte hequr çelësin prej derës duke llogaritur që nëse Rade vjen të mund ta hapë derën, sepse nëse atë e zë gjumi mund të ndodhë që mos ta dëgjojë, kështu që e hoqi çelësin nga dera dhe u shtri për të fjetur. Në mëngjes erdhi kojshikja, atë ditë i kishte thënë, “Po, ndoshta Rade ka shkuar në Kopaonik.” Dhe vëllau qetësohet. Me gjasë ka shkuar në Kopaonik, në atë kohë nuk kishte celular që t’i lajmërohet ndokujt, askush nuk e dinte. Ose ndoshta, ndoshta sorollatët, ndoshta është diku nëpër qytet, tek miqtë apo ngjashëm. Vjen ajo në mëngjes dhe i sjellë disa petulla, nuk e di, dhe i thotë, “Ja, për ty dhe Raden.” “Por, a nuk the më herët që ai ka shkuar në Kopaonik.” “Por, unë nuk e di sigurt, di vetëm...” dhe në atë moment vëllau e kuptoi që ai nuk gjendej, që nuk ka qenë gjithë natën, që askush nuk e di ku është.

Pastaj e thërret kunatën, thërret në Bllacë, ne ishim në Bllacë sepse nëna ime ishte nga Bllaca dhe kemi menduar që aty ishim në mesin e të afërmve, sepse kishim familjes më të largët, edhe djemtë e hallës dhe kështu. Në mënyrë që të mos ndiheshim të huaj, edhe pse refugjati gjithkund është i huaj. Askund nuk është i mirëseardhur, por në rregull. Fatkeqësisht ne nuk ishim as refugjatë, ne ishim persona të zhvendosur brenda vendit, mendoj përgjithmonë, për jetë. Pastaj ai e thirri gruan e vetë dhe i thotë, “Rade nuk gjendët dhe që nuk di se çfarë të bëjë. A ti them Oles? Të mos shkaktoj panik, ndoshta gjendët ndokund, ndoshta ai megjithatë ka shkuar direkt në Kopaonik, kishte ndonjë lidhje të tillë, ndoshta ka shkuar në Beograd për ndonjë arsye sepse i duhej të ishte në Beograd në drejtorinë e “Putnik” sepse aty e kishin thirrur, drejtoresha e kishte thirrur.” Ishte vendi i tij i punës, aty e prisnin, ai donte, ai mendonte që do mund të qëndronte. Thotë ai, “Nuk di çfarë të bëjë.” Këtë unë e dëgjova dhe në atë moment u shkaktua panik dhe isha e vetëdijshme që nuk ishin asnjëra nga ato.

Aty sikur e gjitha filloi dhe nuk e dija se çfarë të bëja dhe pastaj unë kam qenë në shok aq të madh, sa që jam mbyllur në dhomë dhe askush nuk guxonte të hynte, nuk guxonin as të kalonin andej në korridor, por pëshpëritnin në mënyrë që askush të mos më shqetësonte. Unë vetëm ulesha në dhomë, as nuk qaja, vetëm e lusja Zotin që të mos më privonte nga mendja e shëndosh. Sepse për një muaj e humba qytetin tim, banesë, punën, shoqërinë, të gjitha, të gjitha, të gjitha, dhe tani edhe bashkëshortin. Nuk mbeti asgjë, fundi i botës. Vetëm fundosësja, ashtu fundosësja sa që nuk e dija më se ku jam, dhe vetëm e lusja Zotin, “Zot ma ruaj mendjen e shëndosh që mos të më gjuajnë [me gurë] fëmijët në rrugë, Zot ma ruaj mendjen.” Me të vërtetë nuk kishte mbetur gjë, nuk kishte jetë në mua, nuk kishte frymë në mua, nuk e dija se cila ishte rrugëdalja. Nuk kisha vetëdije, kur u vetëdijesova ka qenë vërtetë një panikë e tmerrshme sa që nuk e dija se çfarë do bëja me vetën time. Dhe pastaj kam qëndruar ashtu e mbyllur në dhomë me orë të tëra dhe pastaj jam kthyer në veprim.

Pastaj unë, pastaj fillova të i telefonoja, dhe fillova të telefonoja miqtë dhe armiqtë e tij në Prishtinë. Të gjithë që i njihja në Prishtinë, të gjithëve që ua kisha ndonjë kontakt, kurse kontaktet e mija, të gjitha kishin mbetur në banesën time në Prishtinë, nuk kisha asgjë me vetë. Çfarëdo që mund të zbuloja disi, të thërras, të pyes, nëse dikush di diçka, nëse dikush mund të më thoshte ndonjë gjë. I telefonoja *šiptare* në Prishtinë, kam telefonuar edhe spitalin në Prishtinë për të parë mos ishte në morg, mos kishte ndonjë informatë, kam telefonuar, kam ndjekur, shkova në polici për të raportuar zhdukjen e tij. Në policinë serbe në Bllacë, ata, “Ne nuk kemi kompetenca ‘poshtë’, kështu që pse ta shkruajm atë raport.” Unë çmendesha, duhej të evidentohet diku, ai ishte zhdukur, diçka duhej t’i thuhej dikujt, nuk mund thjesht të heshtnim. Atëherë kuptova për organizata të fuqishme që nuk i njihja apo për të cilat nuk kisha dëgjuar më parë. Nuk e di, për Këshillin e Kishës, këtë, atë, gjithçka kam kuptuar në ndërkohë dhe për Kryqin e Kuq Ndërkombëtar në Nish. Nuk e dija që ekzistonin të

gjitha këto, të gjitha këto ishin në mesin tonë, ndërsa njeriu i zakonshëm nuk i di. Mua m'u shfaqën të gjitha këto dhe filluan të më zhvillohen pllaka sikur fije nëpër kokë dhe kam telefonuar, jam munduar, kam raportuar, kopjuar, dërgoja me faks fotografinë e tij, të dhënat e tij. E ka një shenjë këtu, një pikël këtu, disa përrshkrime naive tani e kuptoj se sa e pafajshme dhe naive isha, kam shkruar gjithçka. Nuk mund të qetësohesha, thjeshtë më duhej të bëja diçka, të mos ndalem, të mundohem të depërtoja deri te dikush, të zbuloja diçka.

E kam ofruar pronën e tij, pronën tonë, kam ofruar çdo gjë, të gjitha që i kishim ia kam ofruar shokut të tij *šiptar*. Ia kam ofruar duke i thënë, “Ti e di se çka posedoj, dokumentacionin e kam unë, tapia është tek unë, kontratat i kam unë, gjeje, sjelle atë në Merdarë, do i marrësh të gjitha, të gjitha do i marrës. Unë do t'i nënshkruaj, por nëse atë e gjen të gjallë. Jo nëse është i vdekur, vetëm nëse është i gjallë.” Ai me gjasë nuk ishte më gjallë dhe nuk është më. Ai miku i tij thoshte, “E di që paratë nuk janë problem, e di që paratë nuk janë problem për Radenë, ai do i kompensonte dosido. E di unë Ola, nuk janë problem paratë por nuk mund ta gjej kurrsesi!” Madje unë zbuloja, e zbulova, thërrisja në Prishtinë dhe i thosha, përsëri mikut të tij, “Kam dëgjuar që Sylja, i cili punonte në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë (MUP), dyshohet që ai ishte polic ‘besnik’”, i cili kishte tradhtuar dhe shkakun i të cilëve shumë polic serb u vranë, por unë këto të gjitha i kuptova më vonë, por nuk e dija. I them, “Kam dëgjuar që në Gërmë,” që është afër Sofalisë, që ishte në fshat afër Prishtinës, “ekzistonte një kamp ku mbahen serbët, ku ka serb, a mund të pyesësh përreth për të parë nëse aty ishte Sylja që punonte në polici, mos është duke e mbajtur aty.” Ai tha, “E njoh Sylen, është këtu afër meje.” Dua të them, unë ankohesha, ndërsa isha duke folur me mikun e Rades, ky ishte mik aq sa ishte dhe ai që punonte në MUP, i cili lajmëronte se ku shkonin [policët] serbët në aksion. Kjo ndodhi më vonë, dhe unë shtangem, them me vete, unë t'i them dikujt diçka. Çfarë jam unë, një vidë e vogël atje, që mundohet t'i shpjegoj dikujt ndonjë gjë.

Ishte tmerr, pas një muaji dhe disa ditë jo më tepër, isha në Bllacë në mesin e pulave dhe në mesin e atyre banorëve, kjo nuk ishte mënyra e jetesës sime fare dhe në mesin e asaj pafuqie në të cilën gjendesha. Pastaj vendosa të shkoj, thjeshtë në mëngjes i kam thënë vëllaut, “Unë nesër shkoj për Beograd.” Ai më pyeti, “Te kush?” I them, “Nuk e di ku do të shkoj, nuk e di. Nuk kam para, nuk kam banesë, nuk punoj, mendoj nuk kam asgjë, unë shkova, po shkoj.” I them, “Po shkoj, më duhet të shkoj, unë nuk mund të qëndroj këtu, po shkoj, do çmendem, unë këtu jam vetëm sepse më duhet, unë po shkoj, po shkoj të provoj diçka, më duhet të bëj diçka, unë nuk mundem kështu.” “Do të vij me ty, në rregull.” Ai më solli, unë vendosa të shkoj në hotelin Putnik, sepse mu kujtua që “Hotel Putnik” në kohën e bombardimeve u kishte ofruar njerëzve, punëtorëve të vet të vinin të akomodoheshin aty. Unë disi kam menduar që do mund të mbijetoja derisa të mendoja se çfarë tjetër mund të bëja.

Erdha kështu në “Hotel Putnik”, normalisht që nuk isha e mirëseardhur pavarësisht gjithave, pavarësisht që Radeja im ishte profesional dhe që një shumë të madhe parash “Putniku” e kishte fituar nga ai dhe pavarësisht që... unë gjithmonë pohoja që, “‘Putnik’ është dashuria e tij e parë, kurse unë isha në vendin e dytë.” Më thanë që drejtoresha kishte thënë, “Mund të rrini një natë dhe nesër...” Unë i thash, “Mirë, faleminderit.” Dhe kam shkuar në dhomë. Pastaj në mëngjes shkova tek drejtoresha e përgjithshme dhe ia arrita që të rri aty edhe më vonë, qëndrova aty katër vite, më duhet ta pranoj kalova nëpër pengesa të dhunshme e kështu me radhë, por ia arrita të luftoj, por në fund të fundit unë nuk kisha ardhur aty vullnetarisht, jo sepse thjeshtë mu kujtua të shkoja, por sepse është ashtu siç është dhe nuk është faji im, nuk e humba unë pronën time, por mua më sollën në atë gjendje. Mbase dikush duhet të kujdeset për mua. Pastaj jam kujdesur vetë për vetën time, kam qëndruar katër vite aty dhe kam qenë e paprekshme sepse kam krijuar barrikada rreth vetës, i kam përdorur disa nga aktivitetet e mija dhe në një moment mu kujtua që mund të bëjë diçka edhe për veten time, qëndrova aty. Edhe pse e kisha kohën e caktuar se sa mund të qëndroja aty, unë qëndrova në mënyrë të paturpshme, asnjë çështje tjetër nuk e kisha zgjidhur.

E di që nuk më donin, por as unë nuk i doja ata sa i përket asaj. Po bëj shaka, unë nuk i urreja, por ata nuk e donin askënd që ishte aty në hotel, edhe pse unë kam luftuar për vendin dhe statusin tim, kështu që mirë e kalonim. Dua të them që në asnjë vend ku dikush shkon nuk është i mirëseardhur. Ata të gjithë mendonin se unë jetoja qetë këtu, por duhej ta pyesnin vetën një moment, çfarë do tu ndodhte poqëse do të ishin në vendin tim? Njeriu ikë që mos të takohet me diçka që do të mund t'i ndodhte, e keqja nuk troket vetëm në dyert e tjerëve. Me gjasë është ky mallkimi i këtyre luftërave, mbase të gjithë mendojnë se vetëm tjetrit mund t'i ndodh, dhe që kjo është larg meje dhe i ndodh dikujt andej, por të gjithëve mund të na trokas, nëse jo kjo e keqe atëherë ndonjë e keqe tjetër. Nuk e di nëse ishte fat apo fatkeqësi, nuk e di, por kështu mendoj.

Unë gjithmonë... më pas jam përfshirë në shoqata të shumëllojshme, që nga themelimi i Shoqatës së Familjeve të Kidnapuara dhe të Zhdukurve, nga dita e parë kam shkuar, nga mbledhja e parë kam shkuar, kisha dëgjuar për të diku, e kisha lexuar në gazeta, shkova tek Kryqi i Kuq dhe aty isha aktive që nga dita e parë dhe iu vërsula kësaj pune dhe puna më shpëtoi që të mbijetoj. Në qoftë se me të vërtetë kam mbijetuar, gjithmonë ia bëj këtë pyetje vetes, sepse i çmenduri asnjëherë nuk e pranon që është i çmendur. Pyetja është se si më ka mbijetuar mendja, të paktën pa u çmendur, sepse do çmendesha prej problemeve, sepse thjeshtë e shihja se si fundosesha, fundosesha, dhe më nuk mbetej asgjë, makina nuk ndalej. Nuk e kam as edhe një kashtë, nuk kam për çfarë të mbahem.

Kam ardhur në Beograd me një valixhe, dhe kjo është e tëra. Mendoj që në disa vite kur njeriu më nuk ka kohë të njoftojë dikë tjetër, mikun, të krijojë ndonjë rreth, të mos ketë të afërt kush do ta rekomandojë atë, kush do thotë një fjalë të mirë për të për çfarëdo çështje, nuk mund ta gjejë vendin e vet, nuk mund të punësohet, nuk mund të, askush nuk do e punësojë atë, as për shitës në tezgë, as për atë, asgjë. Është jashtëzakonisht një ankth i madh. Është një dëshpërim. Njeriu e gjen veten në një harresë, sa që nuk e di nëse është ditë apo natë, sikur të gëlltitesh. Gjithçka më dhimbte. Çdo centimetër i trupit tim më dhimbte. Athua vallë çfarë janë duke i bërë atij, nëpër çfarë po kalon, a po e mundojnë? Unë e di se sa emocional dhe i ndjeshëm ishte ai, i ndjeshëm dhe delikat, por sidomos i ndjeshëm. Unë kur doja t'ia rregulloja thonjtë apo flokët, më thoshte, “Jo.” Unë i thosha, “Po asgjë nuk të bëra.” [Rade] “Thjeshtë për çdo rast.” Sepse nuk i pëlqente asgjë t'i dhimbte, kush e di se çka janë duke i bërë? Unë e kisha njëfarë ngërçi, si një duq në fyt, ndërsa ngërçin në tërë trupin, sa që gjithçka, i gjithë trupi të më ishte i mbuluar me gjilpëra, çdo centimetër i trupit më dhimbte nga ajo shtypje, nga ajo frikë se çfarë ishin duke i bërë atij. Por kurrë asgjë nuk u dëgjua, krahas gjithë kësaj ishte heshtje. Pastaj them jam hedhur në zjarr, në shoqatë ku punoja pothuajse 15 orë.

Natasa Govedarica: Cilin vit është themeluar shoqata?

Olivera Budimir: Ishte në fund të viteve '99, diçka e tillë. Në fillim të vitit 2000 shoqata tashmë ishte e regjistruar. Unë për herë të parë erdha në takim në Kryqin e Kuq Ndërkombëtar, isha kështu në të zeza, ishte dimër, ishte muaji janar, dhjetor, apo kështu pak a shumë, kisha pallto të zezë, kam vënë syze të errëta, ato i kisha për mbrojtje dhe shikoja. Askënd nuk e njihja dhe i shikoja gjithë ata njerëz rreth meje, u ndala tek një derë, dhe i shikoj gjithë ata njerëz të ulur gjithandej. Nëna me dy fëmijë, tre fëmijë të zhdukur, vetëm burrat, bashkëshorti me dy fëmijë, nga disa anëtarë të familjes. Unë vetëm shikoja, vetëm derdhja lot. Nuk e kam folur as edhe një fjalë në atë takim. Vetëm thosha vet me vete, “Zot, Ola, ti je e trishtuar, çfarë po bën ti këtu në mesin e gjithë këtyre, gjithë këtij trishtimi?” Mbase edhe turpërohesha nga gjithë ky pikëllim, se sa pikëllimi ishte mbledhur aty.

Unë shkova, u kputa, shpirti m'u kput në këtë takim, por përsëri jam kthyer në takim. Tashmë isha paksa më e përgatitur, tani filloja të bëja pyetje dhe të kërkoj disa përgjigje që e dija që nuk ekzistonin, por i kam nisur këto pyetje dhe kështu. Dhe më pas kam marrë pjesë në çdo takim, më ishte bërë nevojë tashmë, që të isha në secilin takim të radhës, kështu kam marrë pjesë dhe këtu isha që nga themelimi i tij, prej periudhës së kërkimit të zyrave, prej zgjedhjeve, pas mobilimit të zyrave, nga gjithçka, gjithkund isha unë, vullnetarisht jam regjistruar. Thoshin diçka si, “Është kjo, ajo...” them unë, “Dua të jem aty, unë do të vij, unë do e bëjë”. Mendoj, nuk është se kishte para, nuk kishim asgjë, ne mezi mbaheshim dhe pastaj Kryqi i Kuq Ndërkombëtar na mbuloi [shpenzimet e] hapësirës. E

morëm dekretin e parë, një avokat nga Fondi për të Drejtën Humanitare na e ka draftuar statutin për organizimin e punës, sepse kemi qenë në të njëjtin takim.

Tek ata shkonim shpesh, pasi që i kishim disi afër, në lagjen Slavija, kurse ata ishin afër, në rrugën Avalla, kështu që kur kishim, kur nuk kishim letër, nuk kishim para, nuk kishim asgjë, thoshim, “Eja të shkojmë tek ata të marrim një grumbull me letra.” Dërgonim dikë prej shoqatës dhe na dërgonte ashtu një grumbull, sikur të ishte dikush. Në shoqatë kishim vetëm telefon, nuk kishim as faks. Pastaj unë shkoja tek një kompani biznesi që gjendej në lagjen tonë dhe i lusja ata natyrisht duke përdorur sharmin tim sa herë kisha nevojë të dërgoja ndonjë faks. “Normalisht, që mundeni!” Dhe kështu unë i jepja atyre që të më dërgojnë ndonjë faks apo të më shkruanin në makinë të thjeshtë, sepse as atë nuk e kishim, nuk kishim asgjë, kishim vetëm një kompjuter. Blinim gazetatat, të gjitha me radhë, dhe pastaj i merrnim të gjithë numrat e telefonit, faksit dhe kontaktet tjera, pastaj i njoftonim për ekzistencën tonë të gjitha agjencitë, agjencitë e lajmeve thjeshtë të na regjistrojnë, të na publikojnë, diku... kështu edhe gazetarët edhe njerëzit filluan të na njohin dhe filluan të na thërrasin, të na lajmëroheshin dhe kështu filloi nga hiçgjë.

Prononcimet e para janë shkruar nga njerëzit në letër që unë i kam sjellë [me veti], ajo letra me katrorët e komunës. Sepse kur jam larguar, unë tashme kisha filluar të shkruaj librin “Labirinti i jetës”, por ai në atë kohë nuk ishte libër, ishte ditari im, dhe ishin disa prej atyre letrave të cilat i kisha paketuar në çantën time të dorës dhe unë i kisha sjellë ato dhe në to kam shënuar edhe prononcimet e para. {Olivera flet në mendje me bashkëpuntorët e Shoqatës} “Kur dikush të lajmërohet duhet të bëhet diçka!” Dhe unë e kam përdorur ato njohuritë e mija nga komuna, nga administrata, pastaj fillimisht është lajmëruar një njeri dhe duhej të merrje diçka, të dhënat, pastaj të shkruash diçka, pastaj të krijosh diçka, të shkruash, pastaj e pash që çdo herë e më tepër njerëz lajmëroheshin dhe që kjo paraqiste problem. Le ti përkufizojmë ata, a ishte lajmëruar ndokush apo jo, pastaj kam përgatitur dosje për të gjithë dhe i kam shpërndarë nëpër qytet, pastaj nëpër komuna, dhe më pas e gjitha është degëzuar në ndërkohë, por është dashur që të fillohet nga diçka. Por kam punuar, respektivisht i kam mbajtur ato mbledhje, protestat, që të dëgjohej, qyteti as që dëgjoi ndonjëherë.

Edhe sot e kësaj dite ka shumë të tillë që kurrë nuk dëgjuan, që për mua është shumë e paqartë, kishte shumë mungesë interesimi për kidnapimet e serbëve në Kosovë. Kishte njerëz, çdo ditë e më tepër lajmëroheshin, dhe punohej, për zotën punohej tepër, dhe kjo ishte shumë e veçantë për mua. Unë nuk jam ankuar, sepse përderisa punon njeriu ai nuk mendon sepse është i preokupuar me diçka. Për çdo deklaratë më duhej të mblidhja zemër, sepse duhej të dëgjoje historinë e dikujt tjetër dhe të kaloje nëpër atë histori, kurse unë e kisha timen. Ishin histori të rënda, shumë të rënda. Mua nuk më

lejohej të qaj tani dhe të tregoj emocione, por më duhej të mbaja një lloj maske, një fytyrë të një zyrtari publik, e pastaj në shtëpi të liroj gjithë atë nga vetja. Ndryshe nuk bën, sepse nëse do të qanim, nuk do merrshim rrëfimin. Kështu vijoi e gjithë kjo, e krijuam një bazë të madhe dhe e arritëm një sukses shumë të madh dhe ishim të suksesshëm, edhe në media, e gjithandej.

I kemi përfshirë të gjitha institucionet e mundshme ndërkombëtare që kishin mundësi të marrin pjesë në çfarëdo mënyrë. Por, për fat të keq shumë nga këto institucione që ishin themeluar, mbase luftërat i bartin me vete. Mendoj që këto pune ishin biznes dhe pa ndonjë qëllim që t'u dilet në ndihmë njerëzve. Unë më vonë e kam kuptuar që ne u përdorem nga shumë institucione të ndryshme, që arsyeja e vetme pse ata ekzistonin ishin këto rrëfime, dhe që në të vërtetë askush asgjë nuk ka bërë, sepse nuk kishin pushtetin që ta bëjnë, kurse ata që e kishin as që shqetësoheshin. Kështu që ne, por kjo ka ndodhur pasi unë kam punuar me vetën, nuk kam hequr dorë, këmbëngulja pavarësisht që e dija, por është dashur të rrjetëzoheshin edhe këto institucione ndërmjet vete.

Disa për shembull operonin për ADN ICMP⁶ në Sarajevë, Qendra e Koordinimit në Beograd, Komisioni për të Zhdukurit ishte asokohe në kornizën e kësaj zyre, kështu që ishte një departament i vogël. Pastaj ishte UNMIK-u në Kosovë. Të gjitha këto ekzistonin, por nuk bashkëvepronin me njëra-tjetrën në këto fusha. Bashkëpunonin me disa të tjera por ata duhej të lidhnin marrëveshje dhe t'i tregonin njëri tjetrit se cili ishte kryesori, kush nuk ishte kryesori, kush duhej të vuloste. Ishte një procedurë e tillë deri në atë masë që kur është dashur të themelohej laborator i ADN-së në Beograd dhe që kjo të realizohej ne kishim presion në kuptimin se cili institucion do të jetë i angazhuar, kush do të jetë i përfshirë këtu. A do jenë këta, a do vinin patologët tek ne, na rekrutonin, flisnin fjalë të mira, ne vendosnim, çfarë nuk vendosem. Kur në fund e kuptuam që ky laborator as që punonte për njerëzit tonë, nuk do të punojë, që këto laboratorë janë të llojeve të ndryshme. Në këtë përfundim erdha ditën e parë, në hapjen e laboratorit, erdha në përfundim që ky laborator nuk do të punojë fare, që ky ishte një laborator krimi, që fare nuk do punojë për Kosovën e Metohinë, që për ne ende punohet në Tuzllë.

Ne avokonim, bënim presion mbi qeverinë sepse të gjithë na bënë presion që kjo të themelohej, që kjo të ndodhte, që të vinim deri tek njerëzit tonë sepse e dinim që shumë trupa ishin të shtrirë në patologjinë e Beogradit në morg, që ato duhej të identifikoheshin, vetëm e vetëm për të ardhur në përfundim që kjo nuk do të jetë fare për ne. Mua më është përmbysur rruga në atë hapje, e kuptova që edhe njëherë u keqpërdorëm, që ata do shkojnë në trajnime jashtë vendit, kurse ne do mbesnim aty ku ishim. Fatkeqsisht, këto histori janë zakonisht të tilla dhe kështu angazhimi im zgjati diku tre vite e gjysme. Në fakt, unë nga fillimi i vitit të parë, nga viti 2000 disi kam kuptuar për një shoqatë afër

⁶ Anglisht: *International Commission of Missing Persons (ICMP)*. Komisioni Ndërkombëtarë i Personave të Pagjetur.

Prishtinës, ishte në drejtim të Fushë Kosovës, e dinim që aty ekzistonte një sallë, disa hapësira të mëdha dhe diçka e tillë, dhe e kam ditur që kur kaloja aty e kam të regjistruar, kam kaluar me veturë dhe në forma tjera dhe aty ishin të ekspozuara gjërat e të zhvarrosurve. Tribunali i Hagës i kishte bërë tashme gjurmimet e të varrosurve afër Prishtinës në Dragodan, atë varrezë që e ka krijuar UNMIK-u dhe që aty gjendeshin gjërat e njerëzve që ishin aty. Ne e kuptuam këtë dhe unë vendosa që ata duhet të na i tregonin ato neve sepse ato ua kishin treguar tashmë shqiptarëve, ne poashtu kemi të drejtë t'i shohim. "Nuk bënë, sepse ne nuk mund të ju garantojmë siguri." "Nuk mundeni? Ne do shkojmë vetë."

Pastaj unë e bëra një ngatërresë të madhe, dhe atë personalisht. Unë isha në krye të shoqatës dhe nuk doja të lëshoja pe, disa nga kolegët e shoqatës nuk pajtoheshin me mua. Vet e bëra dhe e mora gjithë përgjegjësinë mbi vete, kisha vendosur ta shtyj përpara këtë punë. U thash, "Mirë, nëse ju nuk doni," Kryqi i Kuq Ndërkombëtar thoshte, "Ne nuk jemi ushtri, ne nuk mund t'ju mbrojmë," "mirë, atëherë ne do shkojmë vetë, do bëhet si do Zoti, ju do jeni përgjegjës nëse vdesim, por ne do të shkojmë!" Pastaj, kur e panë që nuk jemi duke u tallur, që djalli e mori shakanë atëherë ishte në rregull. "Do fotografojmë gjithë ato gjëra, do bëjmë ekspozitën e atyre gjërave". Unë ju them, "Ju lutem, kurrë mos e quani ekspozitë. Ekspozita të asocion në diçka të bukur, në diçka të këndshme, kjo nuk është ekspozitë." "Nuk e dimë si ti themi, nuk ka fjalë tjetër në anglisht," i them, "Ka, quajeni prezantim, paraqitje, quajeni sido, por jo ekspozitë. Ekspozita ka të bëjë me fotografi, ekspozitë pikturash, diçka e bukur. Kjo fatkeqësisht nuk është kurrfarë ekspozite." Në rregull, e miratuan atë dhe ata i fotografuan ato për ne, dhe i printuan në tabela të mëdha dhe i kanë vendosur, madje kishin krijuar edhe një katalog në Graçanicë në Shtëpinë e Kulturës, kështu pastaj ne duhej të shkonim "poshtë".

Tani kishte një tavolinë, kontaktoheshin familjet nga Serbia dhe Mali i Zi, në atë kohë edhe Mali i Zi ishte bashkë me Serbinë. Ftoheshin, informoheshin se në çfarë kohe bëhej nisja, ky apo ai detaj, organizimi i komplet atij udhëtimi. Unë i kam organizuar autobusët nga Nishi, "Nishekspres", por e dija që para kësaj ishte vendosur një bombë në "Nishekspres", unë jam dakorduar me media që ato të mos shkruajnë për këtë, që kjo të mbetej e mbrojtur dhe mediat të mos shkruajnë dhe të ishte kjo e papritur pa kurrfarë buje sepse të gjithë do vdisnim. Ne do shkonim, pavarësisht se ku do të vënin bombën. Kështu ishte. Kam bërë regjistra të fuqishëm, i kam rregulluar ato. Them unë, sepse vetëm unë kam bërë thirrje, të tjerët kanë refuzuar. Të gjithë e kanë të vështirë të përballen me faktet. Shumë familje refuzonin të shkonin dhe të shihnin me pretekstin, "I imi ishte gjallë, unë e kam informatën". Kisha edhe unë informata bardh e zi. Në mëngjes dëgjoj që ishte gjallë, pasdite që ishte masakruar, dhe gjithë kjo prej fillimit në formë cikli. Nuk mund ta injoroja faktin që ndoshta ai ishte i vdekur, doja ta shihja. Gjithë kjo ishte e dakorduar dhe Kryqi i Kuq Ndërkombëtar nxiste funksionimin

e kësaj në mënyrë që e gjitha të shkojë siç duhet dhe madje arrita që të kontrabandoj një gazetar edhe pse nuk ishte e ndaluar, e regjistrova sikur të ishte anëtar i familjes së një të vrari në mënyrë që të vinte me neve.

Pasdite, dikur në mbrëmje dola nga shoqata, më duket që gjithë javën kam punuar në atë drejtim, nuk kam mundur as të fle, aspak nuk kam fjetur dhe në mbrëmje shkoj e qetë, gjithçka është në rregull, e marr miratimin, po shkojmë, gjithçka është në rregull, në mëngjes kur nisem, jo të nesërmen por pasnesër në mëngjes në orën pesë. Vij unë në mëngjes në orën tetë në shoqatë dhe shoh në tavolinë një faks nga UNMIK-u ku ata na refuzojnë shoqërimin. Tani duhej të anulohet e gjitha, gjithë njerëzit që ishin nisur nga Mali i Zi, nga Tivari, nga Titogradi, Podgorica tani, nga gjithë Serbia që janë nisur në drejtim të Beogradit. Si t'ua anulohet? Tu thoshe kthehuni? tashmë ata janë në automjete, rrugës. Pastaj filloi paniku, sepse na refuzuan përcjelljen dhe nuk mund të shkonim, pastaj e njoftoj unë përsëri Kryqin e Kuq Ndërkombëtar të cilët më erdhën në ndihmë. Aty ishte një shefe Nadin e cila ishte shume e sjellshme dhe kemi bashkëpunuar mirë. Pastaj ajo i dërgoi njerëzit e vet, ekipet, thoshte, “E dimë Ola që ti je vet në gjithë këtë, njerëzit tonë do të të ndihmojnë.” Dhe pastaj bashkë i kemi thirrur familjet dhe i kemi anuluar të gjitha, ata tani kërkonin përcjellje për ne, Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, jo ne, sepse dhe ata kishim marrë konfirmimin që mund të kalonin në ditën tjetër, por tani duhej t'i mbledhnim gjithë njerëzit që ishin nisur tashmë, të presim dhe t'i akomodonim në hotele që nuk ishin këtu në afërsi. Kështu e kemi bërë gjithë këtë proces.

Pjesa e dytë

Natasa Govedarica: Unë do t'ju rikujtoj shkurtimisht se ku ishim para kësaj pauze teknike. Keni foli për largimin e organizuar të familjeve të personave të kidnapuar dhe të zhdukur në Kosovë dhe në ditën e parë pasi mësuar që UNMIK-u refuzoi të ju përcjellin. Ju keni qenë diku në atë ditë, kështu që unë ju lus që të përpiqeni të riktheheni memorien tek ai momenti dhe të përshkruani se çfarë ndodhi më pas.

Olivera Budimir: Kryqi i Kuq Ndërkombëtar disi me anë të njohurive apo fuqisë, arriti të marrë këtë leje, dhe ne jemi nisur për Kosovë dhe Metohi, jemi nisur në drejtim të Graçanicës.

Natasa Govedarica: A është kjo hera e parë që shkoni në Kosovë?

Olivera Budimir: Hera e parë. Kjo ishte hera e parë që nisem për Kosovë dhe Metohi pas mërgimit tim nga Prishtina. Ishte shumë e mundimshme. Është nisur një autobus, dy autobus janë nisur, dhe atë

pas asaj ngjarjeje ku “Nishekspressi” kishte shpërthyer, ra në minë, pas asaj masakre që përsëri i ndodhi popullsisë serbe në rrugë, ne u nisëm rrugës për në Kosovë dhe Metohi. Me qëllim e them Kosova dhe Metohia sepse në atë kohë ashtu quhej zyrtarisht dhe nuk mund ta quanim ndryshe. Me legjislacionin serb ende vazhdon të jetë zyrtar, por në atë kohë ishte edhe ndërkombëtarisht. Jemi nisur dy autobusë, kryesisht gra. Kryesisht kishte të moshuara, nëna, motra, bashkëshorte. Nëse ne ishim apo jo më të guximshme, unë nuk e di, por edhe gjatë kohës time në shoqatë më tepër shihja gra dhe bashkëshorte. Gjithmonë lëndohesha me faktin që kur merret parasysh, kur flitet se si e përballojnë nënat, motrat, fëmijët etj. etj. etj., bashkëshortet rrallë herë dikush i përmend sepse ato janë vetëm bashkëshorte. Në shoqatë më së shumti kishte bashkëshorte. Me gjasë ato e kërkonin bashkëshortin e tyre të zhdukur, përfshirë jetën e tyre, ekzistencën e tyre, atë që ato ishin dhe që do ishin. Kjo është injorancë e thellë dhe për këtë do flasim, por kryesisht kishte gra edhe bashkëshorte edhe nëna, burra nuk kishte, nuk di nëse kishte dy prej tyre gjithsej.

U nisëm, unë isha në radhë të parë, në autobusin e parë, në vendin e parë sepse unë jam organizatorja, apo jo, dhe shkoja ku ta di unë ku. Mendoj, ishim duke kaluar nëpër Bujanoc, sepse nuk mundej, nuk na mundësuan kalimin përmes Merdarës, kalonim nëpër Bujanoc dhe aty kaluam nëpër një kalim administrativ, na morën tre ushtar të KFOR-it në një xhip. Kjo ishte përcjellja jonë. Dy autobus me gra dhe para nesh një xhip me tre ushtarë. Duhet ta pranoni në mënyrë të drejtë. Ne asgjë, ne vazhduam tutje guximshëm. E kishim siguruar ujin, ushqimin, unë kisha organizuar që të kishim diçka rrugës dhe kaq. Kjo ishte rruga e re nëpër Gjilan, nëpër Bujanoc dhe Gjilan, një rrugë e hapur rishtazi që unë për herë të parë e shihja. Nuk ishte rrugë e asfaltuar ende vetëm toka ishte gërmuar. Autobusët ngisnin 20 në orë, nuk mundeshin ndryshe sepse bëhej pluhur. Ishte nxehtë, ishte verë, autobusët ngisnin ngadalë.

Kalojmë nëpër fshatrat *šiptarske* ku kishte fëmijë të vogël me uniforma, mua më vinte keq për ta. Nuk i urrej unë ata fëmijë, por çfarë dinë ata në lidhje më atë që i është thënë. Na tregojnë ashtu dy gishta të vegjlit, të veshur me uniformë, të maskuar, trishtim. Asgjë, ne kaluam, erdhëm në Gjilan. Ishte një hapësirë e madhe, kishte tabela të mëdha të dyfishta nga të dy anët të vendosura me shumë fotografi si dhe katalogje, e kështu me radhë. Fatkeqësisht shumë të vdekur, shumë gjëra kishte aty. Unë kam ecur nëpër ato salla sepse ishin që të gjitha të lidhura, nuk më kujtohet mirë sepse kam qenë euforike dhe e lodhur, sepse një javë para kësaj nuk kam fjetur dhe prej nervozës nëse do realizohej, nëse do të kishte sukses. Unë isha organizatorja dhe duke u nisur nga kjo kisha përgjegjësi për këta njerëz e edhe vetën dhe çka nëse ndodh diçka dhe frika ime, të gjitha më ishin grumbulluar në të njëjtën kohë.

Shkoja nga një hapësirë në tjetrën, shikoja njëren fotografi, të dytën, të pestën, të shtatëmbëdhjetën, njëqindpesëdhjetën. Nuk shihja më asgjë nga gjithë ajo, të gjitha ishin të njëjta. Sepse kush nuk vishte xhinse, kush nuk mbathte këpucë, kush nuk vishte, të gjitha ishin të ngjashme, të njëjta dhe pastaj vazhdoja, ecja, shikoja, shikoja dhe një moment nuk mundëm më dhe dal jashtë. Mallkuar qofshin pasojat, asgjë nuk kam parë, por askush aty nuk vinte për të parë. Të gjithë ne kishim ardhur për të pastruar ndërgjegjën tonë, ta pastrojmë atë me shpresë që aty nuk gjenden njerëzit tonë, dhe nuk do i shohim, unë e para. Kam kaluar deri në gjysmën e sallës tjetër dhe më me të vërtetë nuk kisha fuqi, dhe kisha bindjen që do të më binte te fikët.

Në një moment, në një tabelë e pash një fotografi me një këmishë, ishin këmisha teksasi, xhinse, këpucët, rrip, të gjitha të fotografuara në një foto të vogël, dhe filloi të më dridhej nofulla, po... nuk doja të besoja, por disi më dukeshin si të mijat, sikur më përkisnin, diçka kam ndjerë dhe menjëherë dola, u lajmërova tek këta që ishin përgjegjës të cilët duhej kontaktuar në rast që njihnin diçka. U mundova të gjej se çka është e kujt. Më pyetën disa gjëra, të përgjithshme, sa është i gjatë, sa është i rëndë dhe gjëra të tilla, mosha, dhe pohonte me kokë ajo gruaja ashtu, “Po, po, po në rregull”. Unë në bazë të këtyre reagimeve të saja dhe asaj që më është përkthyer e kam kuptuar dhe supozoja që ishte ai. Unë përsëri kisha fuqi të mjaftueshme, edhe pse një fotograf e kishte shënjuar atë dhe unë e kam atë gazetë, me gjasë e kishte vërejtur atë konfuzionin tim dhe pastaj e publikuan fotografinë në revistën lokale “Jedinstvo”.

Megjithatë, unë tejkalova gjithë këtë, hyra në autobus si lidere e grupit, u kujdesa për të gjithë. Lidere e grupit, jo që isha ndonjë lidere por duke qenë se isha organizatore kisha obligim dhe ndjeja nevojën që të gjithë të jenë të mbrojtur dhe askujt asgjë nuk i kam thënë. Mbase nuk doja t’ia pranoja as vetës dhe as të tjerëve që kjo mund të ishte e vërtetë, kështu që askush në autobus nuk e dinte. Dy gra i kanë njohur disa gjëra të njerëzve të tyre, por unë nuk iu thashë asgjë atyre, nëse edhe unë kisha parë diçka, që e kam një gjurmë. Arritëm në Beograd, Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, ata e dinin dhe pas një kohe ata më ftuan dhe aranzhuan që të m’i sillnin gjërat në Zveçan, gjërat e tij të vërteta dhe që këto të më shërbenin edhe për këto tjerat. Për të tjerat kryesisht, por edhe për mua të themi. Mbi të gjitha Kryqi i Kuq kërkoi nga unë që të kujdesesha për to. Unë u thash, “Ju po harroni që edhe unë jam në po këtë histori”. Mendoj, aq shumë kam hyrë në këtë histori sa që të gjithë harruan që unë këtu nuk jam fytyrë zyrtare, por vetëm pjesë e atij grupi, por përpiqesha të merresha me të gjitha këto.

Po shkojmë ne andej, dhe unë isha e bindur që ato nuk ishin gjërat e tij, që unë e kisha parë gabim. Pastaj ne u futëm dhe unë po flas me përfaqësuesit e Kryqit të Kuq që ishin nga Zveçani dhe hymë në oborr, dhe unë gjakftohtë me bindjen që ato nuk janë gjërat e tij, kur në një moment në bari, ishin të

ekspozuara pantallonat, xhinset dhe rripi i tij, të brendshmet e tij, çorapët të cilat ishin të zbathura, këmisha teksasi, të gjitha, këpucët. Këpucët ngjyrë të kaltër të mbyllët nga antilopi, në fotografi dukeshin ato këpucë, dukeshin simbolike, edhe pse në fotografi mund të duken të zeza edhe nëse është e kaltër e mbyllët, edhe pse mua më dukeshin ashtu, sepse në të vërtetë ato ishin të një ngjyre të kaltër të mbyllet por verore. Kur unë i pash të gjitha ato, filloi të më ndalej fryma, nuk mund të merrja frymë. Vinte një erë e fortë, por jo nga era, por nga vet konstatimi. Rrobat ishin të lara por ashtu të lyera me gjak, dhe tani më qëndrojnë në kokë, sepse nuk ishin shpërlarë ato. Ashtu të shqyera në pjesë të caktuara nga çfarë dhe si ishte e gjithë kjo... dhe filloi të më ndalej fryma dhe vrapova në një hapësirë në banjë, dhe fillova të përplasia dhe të bërtisja dhe të përplasia me grushtet e mi sepse doja të isha vetëm dhe doja ta zbrazti gjithë atë që ishte grumbulluar brenda meje deri më tani. Pas një kohe erdhi një grua dhe më dha një pilulë për qetësim të cilën e kam pirë me plot vetëdije që të mos bëja skena aty. Unë nuk kam nevojë për audiencë, nuk kam dëshirë të bëj skena, pra në mënyrë që të qetësohesha dhe jam qetësuar dhe përsëri u ulëm në veturë dhe jemi kthyer përsëri për Beograd, por tani me vetëdijen që ishte ai, ishin gjërat e tij.

Megjithatë, gjitha ato që i kisha parë, më dhanë konfirmimin që ishin të tij, por ku është ai, çfarë ka ndodhur me të? Për fat të keq, në këtë periudhë të punës sime, kuptova sa shumë, kuptova se sa shumë cektësi ka në të gjitha këto organizata, si UNMIK-u, në të gjitha ka cektësi që është e tmerrshme. Pastaj mendoja, mirë, këto janë gjërat e tij, po ku është ai? Ai është i varrosur tek këto varre nën numrin “JA ddd”, mendoj atje “NN” në Dragodan, qëndron mirë atje. Këto janë gjërat e tij por a është ai apo dikush tjetër i varrosur në atë numër dhe atij i atribuohet një tjetër histori. Unë dëshiroj të bëj ADN-ën për ta konfirmuar në mënyrë që unë ta di, a është ai apo nuk është. Normalisht që për këtë duhej kohë dhe ajo për çfarë kam folur unë dhe kam nënshkruar kontrata, marrëveshje e kështu më radhë. E gjithë kjo është një procedurë e madhe për të cilën mua më është dashur të pres edhe dy vite tjera. Por personat nga shoqata ime ende nuk e dinin. Unë ende shpresoja që ato ishin gjërat e tij dhe që ai nuk është aty. Do të thotë, askush nga shoqata ime nuk e dinte që unë kisha gjurmë të tij, që unë i kam gjetur, i kam parë ato gjëra. Mbase doja që këtë ta fshihja edhe nga vetja, që kjo të mbetej fshehtësi.

Asnjëherë nuk kam folur publikisht, kisha mjaftë paraqitje në televizion dhe në gazeta dhe kudo, por këtë histori asnjëherë nuk ia kam thënë askujt, sepse doja që e gjithë kjo të mbetej e groposur diku dhe që të ekzistonte mundësia që ai megjithatë është gjallë diku. Përsëri kisha shpresë, shpresa vdes e fundit. Pastaj kaloi edhe shumë kohë. Ja tani, përderisa të gjithë të cilët janë nisur me mua nuk e kishin konfirmuar identitetin e të afërmeve të tyre, kurse unë kisha gjurmë, pavarësisht që isha nisur thjeshtë për të kontrolluar. Se si është jeta, nuk e dijmë rezultatin asnjëherë. E po mirë, e gjithë kjo ka

zgjatur. Edhe dy vite e gjysmë jam përpjekur të arrijë deri te një shenjë më larg që të nënshkruhet ADN-ja, të bëhet disi. Në fund, kjo u bë vetëm në vitin 2002, kur përsëri kisha një problem me UNMIK-un, dhe përsëri aty ishte Tribunali i Hagës, i cili kishte gërmuar për herë të parë. Por, unë në atë kohë e kam kuptuar, unë kur jam nisur për në Zveçan, sepse edhe njëherë kam shkuar pas herës së parë, e kam informuar kunatin, vëllaun e Rades që edhe ai ta shihte, edhe pse unë e kisha parë tashmë. Kjo ndodhi kur më thirrën nga Kryqi i Kuq që unë të shkoja poshtë, ditën e ditëlindjes. Unë me të vërtetë doja t'i shmangesha, të mos shkoja pikërisht në atë datë, por pastaj ku di unë se kur do të ndodhte. Sepse tashmë makineria ishte aktivizuar dhe thoshin, "Nuk e dijmë se kur do ndodhë hera tjetër". Dhe kështu më duhej të pranoja dhe pikërisht për ditëlindjen time të jem "poshtë" me gjërat e tij.

Kështu që e pamë atëherë edhe kunati im dhe unë, dhe përsëri e konfirmuam dhe përsëri kemi përvojësuar historinë e njëjtë. Në atë kohë unë kisha marrë me vete, isha përgatitur me disa detaje, kam kërkuar nëpër valixhe, nëpër atë gardërobën që kisha marrë për të, që ishte e kufizuar. Një valixhe ishte për të, një për mua dhe kështu kërkoja nëpër xhaketa nëse kishte ndonjë fije floku, mos kishte ndonjë gjë të tij. Të gjitha i kam grumbulluar në disa kесе të vogla, i kisha vënë aty që të bëhej ADN-ja, pra duke marrë për bazë ato. Por, disi ia arrita të gjej stomatologun e tij i cili ia kishte rregulluar dhëmballët, që ai nuk e kishte deklaruar procesverbalin me pacientët e tij, ai në bazë të kujtesës e ka ri-konstruktuar dhëmballat e tij, kështu që unë kam shpresuar që do mund t'i kontribuoj dikujt që aty të kuptohet ndonjë gjë, që diçka të mund të krahasohej. Kur kam arritur në Zveçan, bisedova me patologun sepse ai ishte përgjegjës që të fliste me familjen, dhe kur unë i kam thënë atij që doja t'ia jepja ato, ai më thotë, "Po, por që ai është pa kokë". E ky ishte shoku i dytë. Do të thotë, tashmë isha e shokuar dhe kjo ishte e dyta herë. Kjo nuk mund të vërtetohej. Pastaj e kemi kuptuar që duart i kishte të thyera. Se cilat ishin gjitha detajet unë as që guxoja t'i dëgjoja, nuk mundja, nuk kisha fuqi. Po ashtu, ajo që kam kuptuar... po mirë, ku është gjetur ai? Sepse para asaj, me natë të tëra, kur prisja ta zhvilloja atë bisedën e dytë, dhe të shkoja "poshtë" isha psikikisht e përgatitur dhe pastaj natën, sepse nuk flija dot prej gjithë atyre problemeve të cilat i kam pasur, kam shkruar atë që më binte ndërmend, sepse mund të harroja në momente kur duhej të pyesja, nga konfuzioni dhe problemet, prandaj e shkruaja, mirë ku është gjetur ai?

Nëse UNMIK-u e ka varrosur në Dragodan, do të thotë UNMIK-u është policia, nuk është ndonjë ushtri kashte apo ku di unë, por është policia, policia e rregullt atje "poshtë" që është edhe sot. Ata e kanë gjetur diku dhe e kanë varrosur nën "NN" [pa emër] sepse nuk e dinin kush ishte në Dragodan. Në rregull është "NN" ky dhe ky "JA 42", nuk dihet kush është, por unë kam thënë që ato gjëra janë të tij, ka gjasa të jetë ai. Ku është gjetur ai trup? Ata nuk mund ta kenë futur ashtu në gropë, por duhej ta gjente diku, nën pemë, në ndonjë hendek, kudo, mendoj unë. Këtë nuk e dimë. Nuk mund të mos

dihet, gjithkund bëhej një regjistrim, nuk ekziston mundësia që të mos bëhet regjistrimi. Po, por secila polici e mbante me vete regjistrin. Edhe, gjoja i paska bartur [të dhënat], a e ka bartur apo jo nuk e di, e aty për këto gjashtë muajt e fundit kanë ndryshuar grupe të ndryshme të zyrtarëve policor të cilët kanë ardhur nga vende të ndryshme dhe pastaj gjoja nuk ka informacione se ku u gjet ai. Unë them edhe nëse është gjetur, policia gjeti dikë nën një pemë në një hendek apo kudo, dhe së pari duhej ta dërgonin për të kryer autopsinë, në spital për një autopsi. Është aq normale që të përcaktohet gjendja momentale në të cilën është gjetur ai, pastaj të varrosej. Nuk është kjo diçka koti. Nuk mund të jetë kështu, thashë, “Ku është ai regjistri i autopsisë së parë, duhet të ekzistojë”. Këtë nuk e di, por më vonë Tribunali i Hagës e ka zhvarrosur përsëri.

Tribunali i Hagës e kishte regjistruar sikur atij tashmë i ishte bërë autopsia, jo që i ishte bërë autopsi por që i ishte hapur trupi. Por bazuar në pikat që bëhen në kraharor ekziston një regjistër që i është hapur trupi. Ky është një shok tjetër. Është shok! Kjo është në fakt nxjerrje e organeve sepse trupi edhe ashtu duhet të hapët. Ai ishte njeri i moshuar, dhe zemra dhe ajo dhe kjo, të gjitha duhet të jenë të dokumentuara diku. Ai e dinte sepse kur e kanë bërë atë të radhës sepse atij tashmë ishte hapur, pastaj Tribunali i Hagës ka bërë përsëri autopsinë dhe atëherë ata e kishin parë që atij tashmë i ishte hapur trupi. Në rregull, do të thotë, nuk është në rregull por nuk kam marr asnjë përgjigje më pas dhe mbeta duke pritur që t’i bëhet ADN-ja.

Kishte edhe raste tjera, kam dëgjuar prej një gruaje tjetër e cila po ashtu kishte gjetur bashkëshortin e saj gjoja në Dragodan në mesin e këtyre, ata ia kishin thënë të njëjtat asaj, ajo njëjtë i kishte njohur gjësendet e tij, ia kanë dhënë të njëjtin përshkrim sikurse për Raden. I gjatë, trupmadh, madje për bashkëshortin ishte e shkruar që kishte pasur operacion në apendiks, këtë me qëllim nuk ia kisha thënë asnjëherë. Bashkëshorti i saj nuk e kishte bërë ndonjëherë, pikërisht këtë e tha ajo, tha, “Këtu shkruan që bashkëshorti im e ka bërë operacion apendiksin, kurse ai asnjëherë nuk kishte bërë operacion të apendiksit”. Unë kam heshtur, Rade im kishte pasur operacion të apendiksit dhe kishte një shenjë të madhe nga operacioni, sepse kur ka qenë fëmijë kishte vuajtur dhe kishte qenë çështje jete a vdekje dhe ishte ashtu i qepur në mënyrë të ngathët dhe kishte mbetur një shenjë e madhe. Ka mundësi që e kanë bërë atë lëshim kur i kanë zhvarrosur një nga një.

Do presim ADN-në. Pastaj kjo zgjati edhe dy vite e gjysme sepse pastaj unë kërkoja prej kur kuptova që ADN-ja bëhej në secilin rast në Tuzëll, dhe jo në Beograd siç prisja unë dhe si shpresonim të gjithë, pastaj jam pajtuar me ICMP i kam lutur ata me të cilët bashkëpunoja që kjo të bëhej për Raden pasi që isha në gjurmë. “Ja, kemi diçka, eja ta përmbyllim këtë”. Filloi ai proces, sepse duhej të arrihej

marrëveshje me UNMIK-un që përsëri ta zhvarrosin, t'i bëhet përsëri autopsia, kishte aty ndikim nga një fuqi, por në rregull.

Në atë kohë UNMIK-u më kishte thënë, kurse Beogradi në një takim më tha që nuk duhej të bëhej përsëri, të merrej mostra, sepse motra tashme ekziston, por që ajo mostër është dërguar në Norvegji dhe që ata duhej të kthenin prapa dhe pasi ta kthenin, vetëm atëherë mund të bëhet ADN-ja, pra duke marrë për bazë atë mostër. Unë u them, “Jo, nuk bën ashtu. Unë dua që menjëherë të zhvarroset dhe që tani të merret mostra në mënyrë që kjo të krahasohet me mostrën që e kishim dhënë ne”, përkatësisht familja, nëna e tij, vëllai, motra dhe “jo ajo që është atje. Kjo nuk më intereson, nuk bënë kështu, nuk ka nevojë të jetë ashtu. Vetëm kështu dhe nuk bënë ndryshe!” Dhe kam bërë problem në lidhje me këtë, problem të madh saqë shefi që ishte këtu në Beograd është pezulluar, unë insistoja në këtë timen sepse nuk e dija se çfarë kishin dërguar ata atje dhe cila mostër është dërguar jashtë. “Unë dua që tani të merret mostra. Ju pohoni që ai është Rade?” “Po.” “Mirë, merreni mostrën dhe në bazë të kësaj konfirmojani nëse është apo jo. Vetëm kështu pranoj, kurrsesi ndryshe”.

Vlen të ceket që unë kisha problem jo vetëm me UNMIK-un por edhe me njerëzit e mi, sepse hapja rrugët, sepse ky ishte rasti i parë që është marr përsipër dhe gjithmonë është vështirë të jesh i pari sepse “poshtë” kishim angazhuar patologët serb. Njëri i cili ishte nga Prishtina, i cili e njihte edhe Raden, por jo vetëm për atë, por sepse ai ishte nga Prishtina, nga Kosova dhe Metohia, do të thotë njeri i joni, e konsiderojmë tonin, që ai do e bëjë këtë me zemër, në mënyrë më të sinqertë, me më pak mashtrime, nuk do të ketë mashtrime, kurse ai më thoshte mua, “Ola, po të isha në vendin tënd do e merrja atë, sepse njëqind përqind është e Rades.” I them, “Mirë, nëse thoni ju.” “Unë e njoh atë, ai ishte miku im,” i them, “Në rregull, ta zëmë që unë po pranoj ta marrë atë. Le ta bartim trupin për të cilin thonë që është i Rades dhe ta sjellim këtu dhe do e lëmë në murgun e Beogradit, vetëm le të jetë diku ku është vendi më i përshtatshëm ose unë do e paguaj vet që t'i bëhet ADN-ja.” “Po, por është procedurë e kushtueshme,” më thotë. I them, “A din çka është e kushtueshme, për dikë edhe një riskë bukë mund të jetë e kushtueshme, për dikë as aeroplani nuk është i kushtueshëm. Sa është e kushtueshme kjo procedurë? Çka do të thotë e kushtueshme, më thoni sa kushton?” Unë i them, “Do të paguaj që të bëhet ADN-ja.” Thoshte, “Po, por çka nëse nuk është ai?” “Më parë thatë që ishte ai, çfarë të bëjë unë nëse nuk është ai?” Çfarë të bëj unë, ai kishte harruar që më herët e konfirmoi që ishte ai. Çka do bëjmë me atë trup nëse nuk është ai? Çka do bëj unë nëse nuk është ai? Do të thotë vetëm kështu mund të flisnim.

E pra, kaloi edhe kjo, e kishin bërë megjithatë, po shpresoj që e kanë bërë, sepse unë nuk kam qenë aty, kështu që nuk mund të konfirmoj asgjë. Prezent ishte patologu dhe të tjerë, i është kryer autopsia,

do të thotë për herën e tretë i kanë futur duart nëpër organe apo diçka të ngjashme dhe i është bërë analiza e ADN-së dhe unë e marr konfirmimin nga Tuzlla, përkatësisht nga Sarajeva nga përfaqësuesit e ADN-së që është konfirmuar se ai është Rade Budimir. Por kjo nuk ishte në rregull, sepse unë isha dakorduar, sepse mendoja ta varrosi me datën e asaj dite që ishte zhdukur, sepse nuk e di kur është vrarë ai, nuk e di kur kishte vdekur, asgjë tjetër nuk di, e di vetëm që ishte zhdukur dhe doja që atë ditë të varroset. Unë e mora konfirmimin, informatën që ata nuk mund të arrijnë assesi atë ditë, që e gjitha kishte përfunduar, por që ata nuk kishin se kujt t’ia dorëzonin dokumentet me ADN-ën e konfirmuar sepse nuk ishte nënshkruar marrëveshja në mes të UNMIK-ut dhe atyre, kështu që nuk e dinin se a duhej t’ua dorëzonin ato qeverisë tonë, pastaj qeveria UNMIK-ut apo e kundërta, por asnjëri prej tyre nuk kishin dokumente të nënshkruara mes njëri tjetrit. Rreth vicioz.

Kur herën parë i kisha thënë përfaqësueses në Sarajevë, “E dini çfarë, deri me tani çdo herë që më keni thënë ‘ju kuptoj, e di si ndiheni,’ jo, në rregull është faleminderit shumë, tani do ju them dhe siç gjithmonë them, mos u mundoni ta kuptoni sepse nuk mundeni, as unë nuk do arrija dot ta kuptoja. Nuk mund ta kuptoni por vetëm bëni atë që mund të bëhet, por mos u mundoni ta kuptoni sepse është e vështirë të kuptohet, sepse nuk mund ta kuptojë askush përderisa nuk është në po atë lëkurë. Kurse tani, për herë të parë dua të ju them, dua ta kuptoni, si mallkim, me qëllim e thash për herë të parë sepse kjo nuk është mënyra ime e të folurit. Dua të ju ndodh e njëjta që ju ta kuptoni.” Pas një periudhe të shkurtër, edhe pse periudha kohore nuk ishte e rëndësishme më, u rregullua e gjithë kjo, e gjithë kjo që kam thënë dhe pastaj e kam pranuar atë. Më është dorëzuar në Merdare, përsëri mashtrim. Ishim dakorduar se kur duhej ta pranoja trupin, unë këtu i kisha organizuar të gjitha, tashmë isha dakorduar për funeralin dhe më duhej të shkoja, më duhej të prisja arkivolin në Merdare që ta kalonte kufirin.

Në mbrëmje u dëgjova përmes telefonit me patologun, ai jetonte në Kraljevë, apo në Krushevc, nuk e di, aty diku jetonte, dhe e kam pyetur, “Doktor, ku mund ta di që ata do të ma dërgojnë pikërisht atë?” Për të mos përmendur që unë e dija që kishte mashtrime të shumta, “ku mund ta di unë që nuk do të marrin thesin e parë dhe ta hedhin në arkivol dhe që mua do të ma dërgojnë pikërisht atë, ku mund ta di unë këtë me siguri? Gjithmonë më duhet vetëm të dakordohem dhe asgjë tjetër.” Më tha, “Unë të garantoj për këtë çështje, unë do jem prezent në vendin e ngjarjes edhe kur janë duke e vënë në arkivol unë do jem aty, do jetë i mbyllur në arkivol metalik. Të blinduar, dhe ne do vijmë bashkë me të”. Them unë në mënyrë të qetë, “Të paktën kaq”. Ai e dinte, sepse ai ishte aty gjatë autopsisë dhe e dinte se kush ishte ai. Në mëngjes shkova me familjen time në Merdare, fatkeqësisht njeriu kur është duke vuajtur nuk ka miq. Mbase është ashtu, mbase edhe nuk e di se si është, sepse pastaj edhe vet ishim të lënë pas dore, por mirë kisha familjen time, aty ishin vëllezërit e mi dhe kështu. Arritëm në

Merdarë. Dy vetura ishin të mijat, tri vetura kishim ardhur. Të gjithë dolën dhe ecnin përreth, unë qëndrova ulur në veturë dhe isha mbështjellë në mënyrë që të mos e dëgjoja askënd, të mos e shihja askënd, kështu hyra në veturë dhe aty prisja. Kalojnë minutat si të ishin përjetësi, kurrsesi të arrinte ai furgon, ajo makinë, nuk e dija se në çfarë do e sillnin dhe në një moment më trokitën në dritare. E ngrita kokën, e pash që ishte patologu afër veturës sime. I them, “Çfarë po bëni këtu doktor, a nuk do duhej të ishit në anën tjetër në përcjellje?” Ai më tha, “Unë jam doktor...” nuk më kujtohet emri, profesor doktor, “nuk mundesh ti, si flet me mua ti.” Unë i them, “Doktor, unë në këtë moment jam vetëm gruaja e Rade Budimirit dhe ju pyes se çfarë kërkoni në këtë anë të kufirit nëse duhej të ishit në përcjellje në anën tjetër. Këtë ju e thatë.” Ai natyrisht vazhdoi më tutje dhe më shpalli të paarsyeshme dhe që nuk jam... ku di unë çka dhe gjëra të tilla. Nuk i kisha dëgjuar unë ato, vëllezërit më treguan pastaj.

Pas pak kohe erdhi furgoni dhe e shoqëruam me makina deri tek spitali në Kurshumli. Përsëri, çfarë digresioni, çfarë loje e fatit? Unë ta marrë atë pikërisht në spitalin ku kam lindur, sepse aty jetonte babai im, mirëpo kjo ishte në një podrum në spital të Kurshumlisë, në një bodrum të pakëndshëm dhe të keq por nuk ka rëndësi. Çfarë ishte më e keqja, një traditë e cila ishte larg asaj serbe, sikur UNMIK-u nuk kishte mundësi t’i përballonte shpenzimet. Trupat nuk ishin në arkivol llamarine, por në arkivol të thjeshtë prej druri. Të blinduara në kuptimin se kishte shirita ngjitës përgjatë arkivolit në dy vende, kaq. Mbase të mos hapej kapaku. Ishte mbuluar me shirit ngjitës, e çka është më e keqja që nga ajo veturë, nga arkivoli në thes, në thes plastike e bartin nga një arkivol në tjetrin të cilin familjet duhej ta sillnim. Kjo ishte ndonjë traditë *šiptarski*, tradite myslimane ku arkivoli duhej të kthehej sepse e marrin në xhami, e bartin, e marrin hua dhe pastaj e kthejnë. Ata po ashtu e kanë kthyer arkivolin por ne, unë kisha sjellë tjetrin, jo, unë në të vërtetë, por agjencia e funeralit kishte sjellë arkivolin e blinduar me material të llamarinës dhe pastaj e bartën në të atë thes të bardh plastike dhe dy polic ecnin prapa arkivolit. Kishte edhe shenja gjaku, sipër mund të shihej, shihej që i gjithë trupi nuk ishte dekompozuar pas dy vite e gjysme, ishin bërë tashmë tri vite e gjysme. I gjithë trupi ishte aty, përveç kokës. Shihej kur e ngrinin. E tmerrshme, ishte moment i tmerrshëm. Unë gjatë gjithë kohës isha afër tij, pastaj u dërgua në Beograd.

Të nesërmen e kemi varrosur në varrezat Orlovac, dy mijë njerëz ishin prezent gjatë funeralit. Unë nuk i kam parë, sepse nuk shihja asgjë, por më pas më treguan. Më thoshin, “U mendojshim, athua cili prej zyrtarëve publik ishte aty sepse kishte tepër njerëz në funeral.” Janë mbledhur njerëz nga e gjithë Serbia. Unë nuk kam bërë lajmërimë, e kam shpallur një nekrologji të vogël në gazetë dhe kaq, sepse nuk kam pasë as kushtet për t’i njoftuar. Por ai ishte njëri i tillë, dua të them, aq sa ka njerëz në funeral aq ishte i mirë njeriu, dhe sa shumë njerëz kishin ardhur për ta nderuar në atë momentin e fundit, ka

qenë funeral enorm. E varrosëm dhe kaq. Unë nuk e di dhe kurrë nuk do ta di nëse vërtetë ishte ai. Unë nga kjo iki, refuzoj të mendoj për këtë, sepse më rëndon ky mendim por e kam pyetur veten dhe të tjerët, a kam të drejtë ta bëjë përsëri analizën e ADN-së kur tashme kisha ardhur në këtë pikë, dhe të kërkoj rizhvarrosjen që të bëhet ajo dhe unë ta paguaj. Nuk është problem ta paguaj gjithë këtë, do qetësohesha unë, a është apo jo, por kështu kur hesht ndoshta dikush e kërkon ndonjë të afërm, e ndoshta pikërisht Rade është i shtrirë diku dhe nuk ka se kush ta njoh dhe identifikojë atë sepse tashmë ishte dorëzuar nën atë emër.

Po mendoj, këto janë histori të rënda që palohen njëra pas tjetrës, mirëpo të gjitha që kam bërë në bashkëpunim me UNMIK-un i kam edhe sot në duar. Ata i kishin mbajtur aq shkujdesshëm ato shënime, ato libra. Një emër, një rast, më vjen keq ta quaj kështu sepse fatkeqësisht të gjithë ishin bërë raste dhe numra, dhe kur një numër shënohet për herë të parë duhet të përcillet e gjithë ajo rrugë deri në funeral. Ai kishte tre-katër numra, që të gjitha të ndryshëm, dhe nuk ishte i vetmi, sepse unë i krahasoja edhe të tjerët të cilët ishin marrë përsipër, sepse unë i kisha këto shënime të cilat i kam marrë prej burimeve të ndryshme në UNMIK “poshtë”. Ata edhe nuk e dinë që unë i kam ato, dhe nuk guxoj t’i paraqes, t’i tregoj apo t’i publikoj, sepse do shkaktoj konfuzion të madh. Nuk e di nëse guxoj të hesht. Të gjithë ata që i kanë pranuar do kërkonin rizhvarrosjen. Kurse ata që nuk e kanë pranuar, ndoshta gjithmonë do kërkojnë, por kurrë nuk kanë për ti gjetur të afërmit e tyre. Ky është një rreth i madh vicioz dhe a mund të sillemi të gjithë në atë valle, është e frikshme, tenxherja është duke vluar, ajo vlon, dhe njerëzit që i kanë varrosur të afërmit e tyre e kanë gjetur një lloj qetësie për vete, mos vallë duhet t’ua gërvishtim plagët. Kurse ata që nuk do të gjejnë paqen e tyre sepse nuk do i gjejnë njerëzit e tyre të afërm, a duhet të i lemë të zihen përgjithmonë në atë padijen e tyre. Këto janë tema të mëdha. Nuk jam e sigurt në vete, nuk e di nëse ndonjëherë do e bëjë atë. Ja, tani e thash këtë, por se a do e bëjë, mendoj që... nuk e di, nuk e di se çfarë është e mirë, nuk e di se çfarë është e drejtë, nuk e di, nuk jam e sigurt në vete.

E vetmja gjë që di është që nuk e di pse i ka ndodhur kjo atij dhe të tjerëve. Nuk i kishte borxh askujt dhe shumë më dhemb dhe më vret, kur nga shumë burime dëgjoj që këto krime kanë ndodhur ndaj viktimave të pafajshme serbe, vetëm pas përfundimit të luftës, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Paqes. Pra, nëse kishin marrë atë që donin, pse të vrisnin, pse të dëbonin. Para kësaj e kuptoj që ishte betejë për kinse mbrojtjen e kauzës së tyre, por përse më pas, 99 përqind, ose 95 përqind, të mos them 99 përqind e viktimave janë pas hyrjes së KFOR-it, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Paqes. Pra, pasi ata e kishin marrë territorin, kur tashmë kishin marrë atë që donin, edhe pse kryesisht përmes një lloj kualifikimit ndërkombëtar, atëherë njerëzit janë vrarë dhe atë me tortura të mëdha. Pse të bëhej kjo? Kjo më nuk e ka as të njëjtin kuptim. Ka peshë tjetër të vrasësh në luftë, të vrasësh në

vetëmbrojtje, të vrasësh, dhe tjetër peshë ka të vrasësh kështu pa ndonjë arsye. Ta shqyesh dikë pa ndonjë arsye. Nuk mundem, nuk mundem kurrësi ta kuptoj, dhe së dyti kjo është hakmarrje për disa nga viktimat e tyre.

Nëse shikohen të gjitha, atëherë serbët do duhej të hakmerreshin. Gjithmonë kishte viktimë serbe dhe kjo zgjat prej kur ju kam folur për babin tim dhe para asaj kohe, serbët gjithmonë e kanë pësuar, gjithmonë janë vrarë, dëbuar, gjithmonë kanë ikur nga vatrat e tyre dhe kujt i janë hakmarrë ata, pse? Ne ende jetonim në shtëpitë tona dhe prisim që e gjithë kjo të kalonte dhe të qetësohej gjendja. Do të thotë, nuk ishte as hakmarrje, ishte nevojë për hakmarrje. Të gjitha mund t'i pranoj, por shpirti im nuk mund ta pranoj që dikush të torturojë dikë, që të ketë të drejtën të vras dikë, atë nuk e kuptoj. As një pëllëmbë e gjithë rruzullit tokësor nuk ka vlerë sa një pikë loti njeriu, sa një jetë njeriu. Nuk e kuptoj nevojën që të merret një jetë për çfarëdo lloji ideali. As sot e kësaj dite nuk arrij ta kuptoj. Me vet faktin që i është ndërprerë jeta atij, është ndërprerë edhe e imja.

Natasa Govedarica: Si duket jeta juaj sot?

Olivera Budimir: Pikërisht ky është problemi. Unë kam mbetur e bllokuar në atë pjesë të historisë kur filloi gjithë ai ferr, jo sepse unë nuk dua, jo sepse nuk kam forcë apo që nuk kam vullnet të nxirrem nga ajo, por sepse është kështu. Sepse njeriu diku gabimisht, padrejtësisht, pa meritë, pa fajin e tij vendoset diku, dhe kjo nuk mund të tejkalohet vetvetiu, nuk mund të tejkalohet pa marrë parasysh se si ne sillemi, dhe pavarësisht se sa jemi të vetëdijshëm, nuk ka më asgjë dhe është kështu. Nuk bënë, nuk vjen nga Zoti, nuk është e natyrshme, nuk është normale. Unë mundohem vazhdimisht, ia kam organizuar një jetë vetës, e kam banesën time, nuk jam në rrugë, kam punuar, kam fituar mjaftueshëm që të jetoj një jetë modeste, jam e pavarur financiarisht, kjo është e gjitha. Gjërat materiale fitohen dhe humben dhe kjo fare nuk ka rëndësi. Asnjëherë nuk kam folur se sa shumë kam humbur në aspektin material, asnjëherë nuk flas sepse është e parëndësishme në krahasim me jetën e humbur. Por, jeta ime është e bllokuar aty diku, aty është vënë pika. Prandaj, me vet faktin që i është vënë pika, ky është ai tregimi kur kam thenë që kryesisht vuajnë nënat, motrat, kurse bashkëshortet kinse vuajnë. Nuk është ashtu, unë e kam humbur bashkëshortin dhe si pasojë e kam humbur të drejtën për krijim të familjes, e kam humbur të drejtën për të pasur trashëgimtar të jetës sime, e kam humbur jetën time. Nuk është shkatërruar vetëm një jetë me jetë, por më tepër se kaq. Do të thotë kjo është gama e viktimave, e secilës viktimë.

Kjo bartë në vete më tepër sesa humbja e bashkëshortit. Po, e kam humbur bashkëshortin, por kam humbur edhe të drejtën të jem nënë, të jem gjyshe, dhe të gjitha ato që vijnë pas asaj, do të thotë me vet faktin që ai është zhdukur. Do të thotë, jeta ime është ndalur aty, sepse jeta, shtëpia ime ishte në

Prishtinë, jeta ime ishte në Prishtinë. Unë këtu e kam një banesën, por nuk kam shtëpi, nuk është shtëpi. Shtëpia është aty ku është familja, është aty ku ka krijime, ku ka plane, ku... banesai ime është, falënderoj Zotin sepse unë kam kulm mbi kokë dhe nuk kam nevojë të paguaj qira, por nuk është shtëpi. Të gjithë më thonë që e kam shumë mirë, është e rregulluar mirë, që... për mua është e zakonshme. Për mua kjo është vetëm një vend për të fjetur, për të ngrënë, për t'u pastruar por aty nuk zhvillohet jeta. Nuk është jetë.

Por, nga gjithë kjo, ajo që është shfaqur nga gjithë ky tregim është ky roman, është "Labirinti i Jetës". Unë jam "Labirinti i Jetës", Rade është "Labirinti i Jetës" dhe ka shumë, fatkeqësisht ka shumë si Ola dhe Rade që kanë kaluar nëpër atë ferr që unë kalova. Por, vetëm unë e vetmja e kisha nevojën që të shkruaj në kohën kur gjithë kjo ndodhte, sepse kjo ishte një lloj ushqimi psikologjik. Unë shkruaja në mënyrë që të mos çmendësja. Shkrimi ishte shoqërimi im në mëngjes, natën, kur zgjohesha në katër, kur nuk mund të flija, në orën dy. Kur përreth më fluturonin mendime të llojllojshme, gjithçka e shkruaja, kam mbajtur ditar. Është ditari im i shkruar për mua, jo për publikun, jo për të tjerët, dhe kam filluar ta shkruaj pak para luftës, kur luftoja për amësi. Është dashur të jetë një roman i bukur, një lloj himni i bukur i fëmiut tim, thjeshtë për t'i dhënë fuqi ndonjë gruaje tjetër të cilat do luftonin për dëshirat e tyre. Kështu filloi e gjitha. Pastaj filloi lufta dhe unë thjeshtë vazhdoja të shkruaja. Vazhdoja të shkruaja përderisa binin bombat. Unë gjithë këtë emocion e kam vënë në letër. Kam vazhduar të shkruaj derisa isha në hotel, derisa zgjohesha natën, derisa vrapoja andej e këndej nëpër shoqatë, derisa. Unë vetëm shkruaja, shkruaja, shkruaja dhe pastaj më erdhi një qetësi kur e varrosa atë, kur unë, nëse e kisha gjetur, kam gjetur një lloj qetësie. Mua në një moment mu kujtua romani im, ato shënimet e mija, ditari im dhe e kam kuptuar që unë faqet e fundit i kam shkruar kur e kam varrosur atë. Në atë kohë kam mbaruar së shkruari, nuk e ndjeja nevojën, të gjitha ishin të parëndësishme pas kësaj dhe aty mbaroi.

Kështu një ditë, vendosa t'i transferoja ato t'i rishkruaja, e fitova një kompjuter timin, i cili ishte gjëja e parë që kam marrë, sepse nuk kisha as banesën time, dhe këtë përmes Kryqit të Kuq Ndërkombëtar sepse kur pranoni disa donacione dhe gjëra të tjera, unë zakonisht nuk merrja donacione. Nuk kisha ku t'i vendosja dhe nuk me nevojiteshin. Prandaj, në atë kohë më pyeten së çfarë do merrja unë, makinë për qepje, diçka të tillë. Unë i them, "Unë dua kompjuter." "Por kjo nuk është në ofertë, atë nuk mundemi." "E pra, ma mundësoni, unë e dua atë, mua më duhet kompjuteri sepse dua të shkruaj, dua t'i rishkruaj këto që i kam shkruar në letër tashmë dhe dua t'i rregulloj ato". Shkuan ata, me gjasë ishin duke mbledhur e zbritur dhe unë e fitova kompjuterin dhe shumë të tjerë pas meje sepse u mundova të u tregoj atyre që nuk ishim të gjithë minator, punëtor, rrobaqepës. Dikush nga ne është intelektual, dikush nga ne donte të bënte diçka tjetër. Kjo nuk bënte të ishte komerciale, në mënyrë që

të kishim mundësi të fitonim donacione. Në rregull, për mua ishte komerciale, unë dua të shkruaj libra. E kam gjetur një lloj formule dhe kam thënë, “Ja pra, kjo për shembull, dikush dëshiron të shkruaj punime të diplomës, dikush diçka tjetër”.

Sidoqoftë, ata e kanë vlerësuar nevojën time dhe unë e kam fituar një kompjuter dhe e kisha mjaftë të vështirë që ta rishkruaja gjithë atë, të kaloja edhe njëherë nëpër gjithë jetën time. Unë e detyroja vetën, “Sot do i shkruaj pesë faqe, sot do i shkruaj tri faqe”. Dhe më duhej të shkruaja derisa nuk e shkruaj të tërën, nuk do ndalem, shpirti im e di, unë duhet të kaloj nëpër to. Shumë nga gjërat që i kam shkruar, i kisha harruar. Shumë nga ndodhitë ishin intenzive, kishte shumë gjëra, shumë ngjarje, dhe po mos t’i kisha vënë të gjitha aty, ato thjeshtë do më fshiheshin nga kujtesa. Pastaj, kur kaloja nëpër to, thosha u edhe kjo ndodhi, edhe kjo ndodhi, edhe kjo ndodhi. Unë vërtetë e di që kishte ndodhur, dhe unë e kisha futur atë diku në një qosh të kujtesës sime dhe nuk e kisha më. Pastaj e rishkrova të tërën dhe vendosa ta publikoj. Kam luftuar mjaftë edhe me vetën time, “A kam të drejtë? A kam fuqi? Ky është tregim i imi personal, është tregimi i Rades, a do pajtohej Rade? Por, Rade e dinte. Unë ia kam lexuar disa faqe atij kur ai ishte ende gjallë, kur kam folur për pjesën e parë, kur kam shkruar në lidhje me amësinë dhe nuk protestoi. Përse të protestonte, pastaj e mora vendimin që ta publikoj. Ishte një moment i rëndësishëm për mua, zihesha duke menduar se si do vëntë puna, a do kisha fuqi të qëndroj prapa asaj. “Duhet të qëndroj prapa çdo fjale, pas çdo qëndrimi, prapa gjithë asaj që kishte ndodhur. A do mund të më tradhetojë, a do jem në gjendje të duroj?”.

Gjithmonë dikujt i pëlqen, dikujt nuk i pëlqen, kanë komente të ndryshme. Por, në fund kam vendosur dhe kur ka shkruar për shtyp dhe kur e pranova ekzemplarin e parë e kam ndjerë një lehtësim, sikur të më ishte hequr një guri nga trupi. Sepse kur më tha botuesi, “Këtë tashmë e mori era, kjo tashmë u shtyp, nuk ka më kthim prapa, përfundoi e gjitha”. Në atë moment unë e kuptova që tani unë nuk kisha mundësi të them as po as jo, as që ka përfunduar, është kapitull i mbyllur, dhe unë tashmë nuk kam asnjë të drejtë mbi këtë. Ky tashmë ishte një tregim që doli në publik. Unë edhe vet isha e befasuar, por ndjehesha shumë më lehtë sepse sikur më kishte rënë nga këtu. Aty i kisha vendosur disa fotografi të asaj periudhe të jetës sonë. Disa fotografi të para të udhëtimeve tona, një pjesë të bukur të jetës sonë. Unë nuk e di se sa është e dukshme kjo. Fotografitë janë nga udhëtimet tona, pastaj kjo pjesa tjetër është e punës në shoqatë. Pastaj e punës sime dhe takimeve të mija më njerëz të ndryshëm, me kryeministrin [Zoranin] Gjingjij, me presidentin të republikës së Francës Zhak Shirakun etj., me udhëheqës të ndryshëm e kështu, dhe në fund bodrumi kur unë e mora atë, ku vërehet e gjithë vuajtja dhe pikëllimi im të mbledhura të gjitha në një. Ja, kjo ishte, kjo është e gjitha, por mua më duhej ta vendosja atë këtu. Sepse përmes kësaj shihet e gjitha që ndodhi para asaj.

Do të thotë, ky ishte monumenti më i madh që arrita t'ia ndërtoj. Sa i përket atij që e ka tek varrezat Orlovac, ai mund të rrënohet sikur edhe në Prishtinë, sikurse që i është rrënuar nënës time në Prishtinë. Kjo është diçka materiale. Kurse kjo është edhe materiale por edhe shpirtërore. Ky libër ka shkruar nëpër gjithë botën edhe në Australi edhe në Amerikë edhe nëpër Evropë. Ka shkruar gjithandej, edhe po të ndodhë fundi i botës, një do mbetet diku dhe do vazhdojnë të jetojnë Rade dhe Ola. Mendoj që kjo është diçka që askush nuk mund të ma marrë më. Jam shumë krenare që kisha guximin të shprehi mendimin tim dhe ta shkruaj ashtu siç në të vërtetë ishte. Nuk ka ndikim politik, nuk është nacionalist, as kombëtarë. Nuk ka kurrfarë ngjyrimi. Është vetëm njerëzorë, një histori e zakonshme njerëzore, se si njeriu vuan, se si një njëri i zakonshëm vihet në një situatë pa asnjë meritë të vetën dhe të cilit i duhet ta vuaj, të nxirret dhe të mbijetojë atë, vetëm për disa qëllime më të mëdha të dikujt që nuk e kam idenë dhe ende nuk i kam të qarta.

Pra, është vetëm një tregim i thjeshtë i një njeriu. Thonë që është një histori dashurie, është histori dashurie për mu dhe Raden. Thonë që në shumë mënyra është i dalluar, sepse shumë njerëz nga Beogradi nuk e dinin se si mbijetonim ne në Kosovë. Mua më vjen mirë që kanë mundësinë ta kuptojnë atë nga kjo sepse kjo është vetëm një histori e thjeshtë e një njeriu, një jetë. Sepse ky roman është mjaftë i përhapur, sepse unë e kam prezantuar në Stuttgart, në konsullatë, në panair, mjaftë është përhapur, edhe pse tani më duhet ta shtypi edicionin e dytë dhe përsëri duhen të holla dhe e gjitha është ashtu paksa... por mirë. Pastaj kam marrë falënderime për atë që është shkruar, për punën time. Unë i them që ai e ka shkruar vetveten, sepse jeta e ka shkruar atë por mbase unë atë ashtu e kam paraqitur, në atë mënyrë që kushdo që ta lexojë t'i duket sikur vet kishte kaluar nëpër atë tregim. Ky roman ka peshën e momentit. Ajo që ndodh në moment dhe shënohet nuk mund të përsëritet. Tani kur flas në lidhje me këtë temë, ky tregim tingëllon ashtu butë, nuk e ka atë forcën. Por, këtu është treguar në të njëjtën mënyrë, vetëm se në kohën e ndodhive, e ka atë fuqinë e momentit. Dhe ky është një... është shumë i fuqishëm dhe çdokush që e lexon kalon nëpër të, e përjeton dhe më e vështira është që ta detyrosh dikë ta përjetojë atë në mënyrë që ta kuptojë, që ta vë vetën në një pozitë të caktuar dhe kjo ishte ajo.

Unë u inkurajova pak dhe kështu e shkrova romanin e dytë, "Ruga e Reve". Por ky është një roman ndryshe. Është një roman bredhacak, roman i udhëtimeve, aty edhe ka një histori dashurie etj. Duke qenë se unë jam alpiniste, e kemi vizituar Evropën nëpër tenda dhe kemi vizituar gjëra të llojllojshme, edhe kështjella dhe gjithçka dhe çdo gjë dhe të gjitha këto i kam shkruar dhe mbishkruar dhe normalisht i kam rregulluar të gjitha ato duke krijuar romanin e dytë i cili plotësisht ndryshon nga ky. Por, unë qëllimisht këtë romanin e dytë e kam shkruar dhe shënjuar në këtë mënyrë edhe pse edhe nëpër të shikon vjedhurazi pikëllimi im për atë që ishte, por kjo gjendet vetëm në raste të caktuara.

Por kjo nuk është histori për romanin, sapo desha të them që të gjithë ne që kemi kaluar atë që e kaluam atë përvojë të hidhur në atë mënyrë jemi të shënjuar, ajo na ka shënjuar, nuk kemi nevojë të jemi të mbyllur, të hermetizuar dhe të mbesim aty në atë tregim.

Duhet të ecim tutje. Kjo vetëm dëshmon se tek ne ekzistojnë edhe disa emocione tjera, disa dëshira tjera, disa nevoja të tjera për njohuri dhe për pikëpamje tjera. Pra, nuk mundemi dhe nuk duhet t'ia lejojmë vetës që të mbetemi të mbyllur në një kohë qoftë shpirtërore sepse ajo që na është shënuar nga jeta, nuk do të ndryshohet kurrë. Por, duhet menduar pozitivisht, duhet menduar më tej. Duhet t'i shohim gjërat e bukura. Pas gjithë kësaj, unë e kam detyruar vetën time të shoh gjëra të bukura, jo vetëm këtu, por në përgjithësi. Fatkeqësisht jeta përbëhet prej gjërave të bukura dhe të trishtuara. Mua më ka ndodhur edhe njëra edhe tjetra. Por unë dua të, nuk mund të ushqej urrejtje në veten time. Unë nuk kam urrejtje dhe nuk jam njeri që urrej. Unë nuk kam të drejtë të harroj, unë mbaj mend, por nuk mund të urrej sepse do shkatërroj vetën. Jo sepse do shkatërroj dikë tjetër, vetën do ta shkatërroj. Urrejtja na shkatërron neve personalisht, kurse unë nuk mund ta bëjë këtë.

Për veprimet e tjerëve le të gjykojë dikush tjetër, kurse unë do të shkruaj romane. Edhe pse tashmë e kam shkruar edhe të tretin, por atë nuk do ta publikoj, me gjasë fillimisht do të publikoj këtë që jam duke e shkruar tani. Do të jetë përsëri një histori e dashurisë në luftë. Përsëri do të jetë një labirint por nuk është i imi por mendoj që duhet të shkruhet. Nuk dua që të gjithë të më identifikojë me “Labirintin e Jetës” edhe pse kjo më ka shënjuar dhe nga kjo më njohin. Dua që të ekzistojë edhe “Ruga e Reve”, diçka e bukur.

Natasa Govedarica: Nëse keni edhe diçka që do donit të ndanit me neve, jemi këtu për të ju dëgjuar. Por nëse kjo është e gjitha, atëherë ju falënderojmë.

Olivera Budimir: Mendoj që kjo është e mjaftueshme sepse gjithmonë ka diçka për të shtuar, të hiqet por thelbi është ky. Ka shumë për tu folur sepse janë shumë vite në pyetje. Shtatëmbëdhjetë vite, dhe për shtatëmbëdhjetë vite shumë gjëra janë akumuluar, janë mbledhur...

Natasa Govedarica: Ne ishim te interesuar edhe për atë para shtatëmbëdhjetë [viteve] dhe ju faleminderit që e keni rikujtuar.

Olivera Budimir: Ajo ishte një histori tjetër, një histori e shkujdesur, diçka ndryshe, është një trishtim ndryshe, por ecim tutje. Për një gjë më vjen keq, shumë më vjen keq dhe shumë herë kam menduar pse njerëzit e ndjejnë nevojën t'i bëjnë keq vetës, të tjerëve? Pse njerëzit e kanë nevojën të lëndojnë të tjerët? Pse njerëzit e ndjejnë nevojën të ia mohojnë dikujt lumturinë? Thjeshtë, këtë nuk do ta kuptoj

asnjëherë, nuk e di. Unë sinqerisht dëshiroj që personi që ishte duke e shikuar Raden në sy derisa vdiste të mos e harrojë kurrë atë dhe që ai vetvetiu të përmbysset në shtratin e tij dhe ta kujtojë atë. Unë nuk do doja të takohem më të, nuk do doja ta dijë se kush e ka bërë atë, sepse nuk do doja t'ia mbaj mend sytë e tij, fytyrën e tij. Nuk do kisha mundësi të flija me atë imazh. Edhe nëse do më thoshin, “Ja do bëjmë çfarëdo që ti do, çka do që mendon ti, ja po ta dorëzojmë ty?” Unë përsëri nuk do mund të bëja asgjë. Nuk do të mund as ta godisja me pëllëmbë sepse unë nuk jam njeri i tillë, sepse unë nuk jam mësuar të lëndoj askënd. Por, sinqerisht dëshiroj që kurrë të mos i harroj sytë e tij. Sytë e tij mirëdashës, sepse besoj që edhe në ato momente kur ishte duke vdekur nuk e besonte që ishte e vërtetë, që megjithatë mund të ishte shaka, që nuk po ndodhte ajo.

Natasa Govedarica: Ju faleminderit edhe njëherë.